



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 614 Akti

Nr. 676 Vendimi

Tiranë, më 19.6.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Brunilda Bektoshi Kryesuese
Etleda Çiftja Relatore
Lulzim Hamitaj Anëtar

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Resilda Bilaj, në prezencë edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, në datën 16.6.2023, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla Ovale, kati 1, Tiranë, mbylli seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Alma Kodraliu**, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë** dhe nenet A, B, C, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisioneren Etleda Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit Alma Kodraliu dhe, pasi shqyrtoi çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, e cila në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Znj. Alma Kodraliu është subjekt i rivlerësimi për shkak të funksionit të saj si gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).
2. Znj. Alma Kodraliu, bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimi, duke u shortuar në datën 15.6.2020 me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët Brunilda Bekteshi, Etleda Çiftja dhe Lulzim Hamitaj.
3. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimi të hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (aktualisht Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e informacionit të Klasifikuar), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; si dhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.
4. Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), me vendimin datë 15.1.2.2020, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimi të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimi dhe të caktojë kryesuese të trupit gjykues komisioneren Brunilda Bekteshi. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.
5. Në datën 13.1.2021, përmes postës elektronike¹, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimi për fillimin e procesit të rivlerësimi dhe mbi përbërjen e trupit gjykues, si dhe i kërkoi të deklaronte nëse gjendej në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues. Komisioni gjithashtu i kërkoi subjektit informacion shtesë sipas pyetësorit standard.
6. Trupi gjykues, me vendimin datë 1.6.2023, vendosi: (i) të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimi Alma Kodraliu, bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatori i çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimi mbi rezultatet e hetimit kryesisht, sipas ligjit nr. 84/2016, të drejtën për të paraqitur prova/shpjegime me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimi për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimi mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe me afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta.
7. Në datën 5.6.2023, përmes postës elektronike², trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimi mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën jo më vonë se data 16.5.2023; (iii)

¹Email datë 13.1.2021: “Njoftim për fillimin e procesit të rivlerësimi dhe kërkesë për informacion shtesë”.

²Email datë 5.6.2023: “Komisioni – Njoftim mbi rezultatet e hetimit kryesisht për procesin tuaj të rivlerësimi”.

njohten me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative.

8. Në datën 12.6.2023, subjekti paraqiti me anë të postës elektronike³ dhe pranë Komisionit⁴ pretendimet me shkrim dhe dokumentacionin justifikues, bashkëlidhur pretendimeve në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht.

9. Më tej, Komisioni njoftoi subjektin e rivlerësimit me anë të postës elektronike⁵ se trupi gjykues, me vendimin datë 13.6.2023, vendosi ta ftojë për t'u dëgjuar në seancën dëgjimore lidhur me rezultatet e hetimit për vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, në datën 16.6.2023, ora 12:00, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative.

II. SEANCA DËGJIMORE

10. Në datën 16.6.2023 u zhvillua seanca dëgjimore në prani të subjektit të rivlerësimit dhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht në seancë.

11. Relatorja e çështjes paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni përgjatë fazës së hetimit administrativ, të kryera mbi të tria kriteret e rivlerësimit dhe të kaluara si barrë prove apo për shpjegime.

12. Znj. Alma Kodraliu, pasi dëgjoji relacionin e paraqitur nga ana e relatores së çështjes, shprehu qëndrimin e saj, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj.

13. Në përfundim të seancës dëgjimore të datës 16.6.2023, subjekti i rivlerësimit Alma Kodraliu kërkoi konfirmimin në detyrë.

14. Seanca dëgjimore e datës 16.6.2023 u ndërpre, për të rifilluar në datën 19.6.2023 për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

15. Subjekti i rivlerësimit Alma Kodraliu ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

16. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016.

17. Sipas krerëve IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016: (i) ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për

³ Email datë 12.6.2023: "Qëndrimi lidhur me relacionin".

⁴ Prapësime të subjektit Alma Kodraliu, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në përgjigje të barrës së provës (nr. *** prot., datë 12.6.2023, në Komision).

⁵ Email datë 13.6.2023: "Komisioni – Ftesë për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore publike lidhur me procesin tuaj të rivlerësimit".

të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror; (ii) AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit; (iii) KLGJ-ja është organi ndihmës për vlerësimin profesional, i cili në përfundim të shqyrtimit të dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe pesë dokumenteve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

18. Referuar vendimit nr. 2/2017⁶ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

19. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Alma Kodraliu, e cila është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

20. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave privatë për vitet 2003 – 2004 në funksionin oficerë e policisë gjyqësore, më pas për vitet 2009 – 2016 në funksionin e gjyqtarës dhe në datën 26.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting* 2017. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, është konstatuar: (i) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

21. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting* 2017; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat vjetore të

⁶ “Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5 të nenit 179/b të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, ndërsa sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore, që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016 parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

deklarimit të pasurisë në ILDKPKI për vitet 2003 – 2004 dhe 2009–2016; (ç) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (d) deklaramet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (dh) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit e në vijim deri në ditën e seancës dëgjimore; (e) deklaramet në seancë dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

22. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarameteve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarameteve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesit.

Personat e lidhur apo të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit që janë hetuar

23. Për efekt të procesit të rivlerësimit, personat që janë hetuar si të lidhur apo të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit janë si vijon: I. Ç., e bija e subjektit të rivlerësimit, konsiderohet person i lidhur; E. K., nëna e subjektit të rivlerësimit, konsiderohet person i lidhur.

24. Në lidhje me pasuritë dhe likuiditetet e deklaruar në deklaratën e pasurisë *Vetting* 2017 nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur

1. Vlera monetare në shumën 13.200 euro

1.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti ka deklaruar: “Aktualisht pasuria që disponoj, është vetëm në vlerën monetare në shumën 13.200 euro, e ndodhur si më poshtë: 8.000 euro në llogari bankare në ProCredit Bank sh.a., në emrin tim, me nr. ***, depozituar në datën 24.1.2017; 2.100 euro, dhënë hua me afat shtetasit A. M. sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 27.10.2016, përpiluar nga noter Gj. K.; 3.100 euro gjendje cash”. Si burim krijimi, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kjo pasuri është krijuar ndër vite, si vijon: “800.000 lekë, nga kursimet e familjes sime pas viteve 1990, të prindërve të mi (me të cilët kam jetuar)⁷; 350.000 lekë, në vitin 2009 të ardhura si rrjedhojë e përfitimit të pjesshëm në shitjen e banesës në Shkodër (në shumën 150.000 lekë), tërheqja e dividendit të përfutur si rrjedhojë e marrjes pjesë në ankandin e Bankës së Shqipërisë në bono thesari, datë 20.2.2009, në shumën (52.271 lekë), si dhe pjesa tjetër kursime nga paga. Kjo shumë është mbajtur në gjendje cash; 250.000 lekë, kursime në vitin 2010 nga paga e mbajtur gjendje cash; 425.000 lekë, kaluar në 1.2.2016 në llogarinë time në Bankën Credins si ekzekutim i detyrimit lidhur me vendimin nr. ***, datë 7.10.2015, të Gjykatës së Apelit Durrës. Kjo shumë është tërhequr nga llogaria në Credins,

⁷ “Kjo shumë është mbajtur cash dhe është mbledhur si rrjedhojë e kontributit kryesisht nga puna ime gjatë viteve 1999 – 2006 (paga është dorëzuar tek prindërit), pensionet e prindërve, si dhe nga qiraja e banesës në Shkodër në vitin 2006 (kur së bashku me prindërit jemi transferuar në Tiranë në tetor 2006) deri në shkurt 2009, kur ajo u shit. Për periudhën e dhënies me qira të banesës nuk ka dokumentacion, pasi kjo marrëdhënie është administruar nga babai pa kontratë. Pas vdekjes së babait, pas disa muajsh është formalizuar prej meje një kontratë me shkrim me qiramarrës të tjerë, për periudhën mars 2008 – dhjetor 2008. Më pas banesa është shitur. Këtë shumë monetare të kursyer ndër vite prindërit ma kaluan mua pas fillimit të shkollës së Magjistraturës, pa akt formal për shkak të marrëdhënies familjare, shumë e cila është deklaruar prej meje para fillimit të detyrës në vitin 2009 të fillimit të punës në gjykatë dhe është mbajtur gjendje cash”.

është kthyer në euro dhe është mbajtur në gjendje cash". Për vërtetimin e deklaramit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues⁸.

i) Lidhur me krijimin e shumës 8.000 euro (depozituar në datën 24.1.2017 në ProCredit Bank)

1.2. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentin "Lëvizjet e llogarisë" të ProCredit Bank, ku pasqyrohet se në datën 24.1.2017 është depozituar një shumë prej 8.000 euro nga ana e subjektit me përshkrimin "Kursime familjare".

1.3. Në DIPP-në e vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: "*Pakësim pasurie në shumën 8.000 euro, depozituar në ProCredit në llogari rrjedhëse në euro në emrin tim. Në datën 25.7.2017, kjo shumë është kaluar në llogarinë bankare të vajzës sime në D. Bank në Berlin, më qëllim mbulimin e studimeve shkollore të saj për vitin e dytë*".

1.4. ProCredit⁹ Bank konfirmon çeljen e llogarisë rrjedhëse në monedhën euro nga subjekti në datën 24.1.2017, si dhe depozitimin e shumës 8.000 euro.

1.5. Më tej, konstatohet se në datën 25.7.2017 ka kryer një transfertë ndërkombëtare në shumën 7.960 euro me përshkrimin "Pagesa e vitit shkollor për vajzën time nga Alma Kodraliu për I. Ç., D. Bank Privat-*** AG", si dhe janë mbajtur 30 euro komisione. Kjo llogari është mbyllur në datën 31.7.2017.

1.6. Sa më sipër, vërtetohet se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin justifikues.

ii) Lidhur me shumën 2.100 euro, dhënë hua shtetasit A. M.

1.7. Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar: "*2.100 euro ndryshuar destinacioni. Kjo shumë ka qenë gjendje cash si rrjedhojë e kursimeve në vite dhe në fillim të tetorit 2016 i është dhënë hua shtetasit A. M. Për këtë shumë nuk ka ndryshim në pasuri, por nuk e disponoj për shkak të dhënies hua*".

1.8. Në deklaratën noteriale nr. ***, datë 27.10.2016, të paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting* 2017, shtetasi A. M. ka deklaruar se ka marrë nga Alma Kodraliu shumën 2.100 euro, të cilën e ka depozituar në llogarinë e vajzës së tij N. M. pranë Raiffeisen Bank sh.a., si dhe deklaroi se është dakord që këtë shumë vajza e tij do e shlyejë deri në fund të vitit shkollor 2016 – 2017 me këste, duke e depozituar në llogarinë bankare të znj. I Ç. pranë D. Bank në Gjermani.

1.9. Në përgjigje të pyetësorit standard¹⁰, subjekti ka deklaruar kthimin e huas prej 2.100 euro të dhënë *cash* shtetasit A. M., shumë e cila është kthyer në datën 12.6.2017 dhe 25.7.2017, duke u depozituar në llogarinë në euro të vajzës së saj në Raiffeisen Bank. Gjithashtu, rezultoi se subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar kthimin e shumës 2.100 euro nga shtetasi A. M. në DIPP-në e vitit 2017, duke u shprehur se ai e ka depozituar në llogarinë e vajzës së saj në

⁸ Nxjerrje llogarie ProCredit Bank, datë 24.1.2017, në emër të subjektit Alma Kodraliu; deklaratë noteriale nr. ***, datë 27.10.2016, me deklarues A. M.; vërtetimet nr. *** dhe *** të datës 12.1.2017 nga ISSH-ja Shkodër; kartelë e klientit, datë 19.2.2010, nga Banka e Shqipërisë, në emër të subjektit Alma Kodraliu dhe urdhër-transferta në emrin e subjektit Alma Kodraliu; vendimi nr. ***, datë 7.10.2015, i Gjykatës së Apelit Durrës; nxjerrje llogarie nga Credins Bank, datë 25.1.2017; vërtetim nr. *** prot., datë 20.10.2016, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; kontratë shitblerjeje pasurie e paluajtshme, nr. ***, në shkurt 2009; kontratë shitblerjeje pasurie e paluajtshme nr. ***, datë 22.6.1993; vendim nr. ***, datë 11.2.2008.

⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 12.2.2021.

¹⁰ Email datë 1.2.2021.

Raiffeisen Bank, ku në datën 12.6.2017 ka depozituar shumën 499 euro dhe në datën 25.7.2017 1.599 euro.

1.10. Nga informacioni i administruar prej Raiffeisen Bank¹¹, konstatohet se në datën 12.6.2017, në llogarinë e shtetases I. Ç., pasqyrohet shënimi “A. H. M. derdh në llog. shlyerje huaje pag. shkolle” në shumën 499 euro dhe në datën 25.7.2017 pasqyrohet shënimi “A. M. derdh në llog. shlyerje huaje 1.600 pag. shkolle” në shumën 1.599 euro.

Analizimi i burimeve të krijimit të shumës 10.100 euro

1.11. Referuar deklarimeve të subjektit të rivlerësimit ndër vite dhe në deklaratën *Vetting* 2017, Komisioni analizoi krijimin e gjendjes së likuiditeteve *cash*, që kanë shërbyer si burim për shumën 8.000 euro të depozituar në ProCredit Bank dhe shumën 2.100 euro, dhënë hua shtetasit A. M.

1.12. Në vijim të kësaj analize, Komisioni konstatoi se vlera e likuiditeteve të deklaruara në deklaratën *Vetting* 2017 përputhet me atë që del si rezultat nga përlllogaritjet e bazuara në deklaratimet në DIPP-të vjetore.

1.13. Më tej, Komisioni analizoi ligjshmërinë e krijimit të kursimeve në shumën 1.400.000 lekë, të cilat kanë shërbyer si burim për depozitim e shumës 8.000 euro pranë ProCredit Bank dhe për dhënien e huas shtetasit A. M. në vlerën 2.100 euro, konkretisht kursimet në shumën 800.000 lekë përpara fillimit të detyrës, shumat 350.000 lekë në vitin 2009 dhe 250.000 lekë në vitin 2010.

Krijimi i shumës 800.000 lekë

1.14. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti ka deklaruar si burim krijimi: “...si rrjedhojë e kontributit kryesisht nga puna ime gjatë viteve 1999–2006 (paga është dorëzuar tek prindërit), pensionet e prindërve, si dhe nga qiraja e banesës në Shkodër në vitin 2006 (kur së bashku me prindërit jemi transferuar në Tiranë, në tetor 2006) deri në shkurt 2009 kur ajo u shit”.

1.15. Në deklaratën përpara fillimit të detyrës të datës 6.2.2009, ka deklaruar si burim krijimi: “Bursa e Shkollës së Magjistraturës. Qira e banesës në Shkodër për dy vjet e gjysmë. Pagesë nga universiteti “***” për 1 vit”.

1.16. Komisioni konstaton një mospërputhje midis burimit të deklaruar në deklaratën *Vetting* 2017 dhe atij të deklaruar në deklaratën përpara fillimit të detyrës të datës 6.2.2009. Konkretisht, në deklaratën *Vetting* 2017 ka deklaruar si burim kursimet e prindërve pas viteve ‘90, të përbëra nga pensionet e tyre, të ardhurat nga qiraja e apartamentit për periudhën 2006¹² – 2009¹³ dhe paga e subjektit 1999 – 2006, ndërkohë që në deklaratën përpara fillimit të detyrës ka deklaruar vetëm të ardhurat e saj nga Shkolla e Magjistraturës, nga mësimdhënia dhe të ardhurat nga qiraja e apartamentit në Shkodër.

1.17. Sa më sipër, Komisioni, duke iu referuar qëllimit dhe objektit të kontrollit të pasurisë sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe jurisprudencës së deritanishme të Kolegjit¹⁴, të cilat kanë përcaktuar qartësisht se procesi i

¹¹ Shkresë nr. *** prot., datë 16.2.2021.

¹² Duke nisur nga momenti i transferimit në Tiranë.

¹³ Deri në momentin e shitjes së apartamentit.

¹⁴ Vendim nr. 33, datë 3.11.2021 (paragrafi 26–27).

rivlerësimit fillon nga deklaratimet e subjektit të rivlerësimit për efekt të procesit të rivlerësimit, mori në analizë dhe verifikoi burimet e krijimit të këtyre likuiditeteve, duke u bazuar në deklaratimin e subjektit në deklaratën *Vetting* 2017.

1.18. Për efekt të analizës financiare, Komisioni mori në konsideratë: (i) të ardhurat nga pensioni i nënës për periudhën 1992 – 2008¹⁵; (ii) të ardhurat nga pensioni i të ndjerit baba të subjektit për periudhën 1992 – korrik 2007¹⁶; (iii) të ardhurat nga paga e subjektit për periudhën 2005 – shtator 2006¹⁷ (subjekti nuk ka deklaruar kursime nga paga në deklaratat e pasurisë së viteve 2003 dhe 2004 e, për rrjedhojë, për efekt të analizimit të burimit për shumën 800.000 lekë, janë konsideruar të ardhurat nga paga duke filluar nga janar 2005); (iv) të ardhurat nga qiraja e apartamentit në Shkodër nuk u konsideruan sipas trajtimit dhe arsyesimit në seksionin përkatës të këtij vendimi; (v) shpenzime jetese¹⁸ prindërit dhe subjekti me vajzën, respektivisht për periudhat për të cilat janë përlogaritur të ardhurat; (vi) shpenzime shkollimi të vajzës pranë shkollës jpublike “***”, Shkodër¹⁹.

Tabela nr. 1 – Analiza financiare e shumës 800.000 lekë

Përshkrim	Vlerë
Likuiditete <i>cash</i>	800,000
Likuiditete në bankë	6,316
Total i likuiditeteve	806,316
Të ardhura subjekti nga pagat (2005 – shtator 2006)	1,059,612
Të ardhura nga pensioni nëna (1992 – 2008)	1,442,992
Të ardhura nga pensioni babai (1992 – korrik 2007)	1,366,833
Të ardhura nga qiraja e banesës në Shkodër	-
Total të ardhura	3,869,437
Shpenzime jetese prindërit (1992 – 2008)	2,216,021
Shpenzime jetese subjekti dhe vajza (2005 – shtator 2006)	383,450
Shpenzime shkollimi vajza në Shqipëri (2004 – 2006)	100,000
Total shpenzime	2,699,470
Balanca e fondeve (të ardhura – likuiditete - shpenzime)	363,650

1.19. Sa më lart, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit dhe prindërit e saj kanë pasur burime të ligjshme financiare për krijimin e kursimeve në vlerën 800.000 lekë, e deklaruar në deklaratën e pasurisë përpara fillimit të detyrës të datës 6.2.2009.

Krijimi i shumës 350.000 lekë në vitin 2009

1.20. Në DIPP-në e vitit 2009, subjekti ka deklaruar: “*Të ardhura në lekë të kursyera nga paga në shumën 350.000 lekë*”. Ndërsa në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se burim i saj është përfitimi i pjesshëm në shitjen e banesës në Shkodër, në shumën

¹⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 21.3.2023.

¹⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 21.3.2023.

¹⁷ Vërtetim i lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

¹⁸ Shpenzime jetike të përlogaritura: (i) 66% e të ardhurave për periudhën 1992 – 1999, (ii) bazuar në shkresën e ILDKPKI-së me nr. ***, datë 4.3.2019 për periudhën 2000 – 2016, në mungesë të të dhënave për vitin 2001 u konsiderua vlera e vitit paraardhës (108.000 lekë/vit për person), ndërsa vlera për vitin 2007 është saktësuar sipas shkresës nr. ***, datë 27.5.2008, të INSTAT-it, drejtuar ILDKPKI-së (174.072 lekë/vit për person).

¹⁹ Vërtetim nr. *** prot., datë 13.4.2023, paraqitur nga subjekti në pyetësorin nr. 1.

150.000 lekë, tërheqja e dividendit të përfituar si rrjedhojë e marrjes pjesë në ankandin e Bankës së Shqipërisë në bono thesari, në datën 20.2.2009, në shumën 52.271 lekë, si dhe pjesa tjetër kursime nga paga. Kjo shumë është mbajtur në gjendje *cash*.

1.21. Për sa i përket investimit në bono thesari në vitin 2009, nga dokumentacioni i administruar²⁰ rezulton se në datën 11.2.2009 subjekti ka depozituar 650.000 lekë në llogarinë e saj pranë Raiffeisen Bank, duke i bllokuar këto fonde deri në datën e zhvillimit të ankandit, më 20.2.2009, datë në të cilën është kryer edhe investimi. Më tej, në datën 2.3.2009, subjekti ka tërhequr interesat e përfituar në shumën 51.271 lekë, shumë e cila është deklaruar nga subjekti edhe në DIPP-në e vitit 2009²¹.

1.22. Investimi në bono, në shumën 650.000 lekë, është maturuar më 18.2.2010, duke iu transferuar subjektit në llogarinë e tij pranë Raiffeisen Bank, në datë 20.2.2010²² dhe është tërhequr nga subjekti në vijim, deri në fund të muajit prill 2010.

1.23. Në procesverbalin e datës 28.10.2016 të ILDKPKI-së²³, subjekti ka dhënë disa shpjegime plotësuese, duke deklaruar se në vitin 2009 ka pakësuar 650.000 lekë nga kursimet e mbartura, për t'i investuar në bono thesari dhe ka shtuar 350.000 lekë të kursyera nga pagat (përkundrejt shtesës prej 350.000 lekësh, që ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2009). Po kështu, në procesverbal ka deklaruar që në vitin 2010 ka shtuar 650.000 lekë nga maturimi i bonove dhe ka shtuar 250.000 lekë të kursyera nga pagat (përkundrejt shtesës prej 250.000 lekësh që ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2010).

1.24. Komisioni, duke marrë në konsideratë faktin se pakësimi i shumës 650.000 lekë për vitin 2009 dhe shtesa në shumën 650.000 lekë në vitin 2010 (të deklaruara në procesverbal) nuk mund të merren në konsideratë për sa kohë nuk janë deklaruar në deklaratën periodike vjetore përkatëse, kreu analizën financiare për periudhën 7.1.2009 – 31.12.2009 për pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin dhe personat e lidhur, të pasqyruara në tabelën si vijon:

Tabela nr. 2 – Analiza financiare për periudhën 7.1.2009 – 31.12.2009

Përshkrimi	Vlera
Ndryshim likuiditete <i>cash</i>	350,000
Investim në bono thesari	650,000
Ndryshim likuiditete bankë	31,670
Total ndryshimi i likuiditeteve	1,031,670
Të ardhura nga pagat subjekti	738,406
Të ardhura nga shitja e pasurisë së apartamentit në Shkodër (1/12)	147,505
Të ardhura nga qiraja e banesës në Shkodër	0
Të ardhura nga interesa bankare neto (investimi në bono thesari)	52,271
Total të ardhura	938,182
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI – INSTAT	273,240
Total shpenzime	273,240
Balanca e fondeve (të ardhura - ndryshim likuiditete - shpenzime)	-366,728

²⁰ Shkresë nr. ***. datë 5.2.2021, administruar nga Komisioni dhe kartela e klientit, paraqitur nga subjekti në përgjigje të pyetësorit standard.

²¹ Subjekti ka deklaruar: “Interes nga bono thesari për vlerën e depozituar në Bankën e Shqipërisë në shumën 650.000 lekë, me vlerë 52.271 lekë”.

²² Me përshkrim “BOA për sa transferuar fondet me kërkesë të klientit”, vlerë 644.128 lekë.

²³ Shkresë nr. *** prot., datë 3.3.2023.

1.25. Referuar analizës financiare, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën 366.728 lekë për kryerjen e shpenzimeve, shtesën në kursime dhe investimin në bono thesari për periudhën 7.1.2009 – 31.12.2009.

Kursime cash nga paga në shumën 250.000 lekë, në vitin 2010

1.26. Subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2010 ka deklaruar: “*Kursime në lekë, jo në llogarinë bankare, në shumën 250.000 lekë*”, nuk deklaroi burimin e krijimit. Ndërsa në deklaratën *Vetting* 2017 ka deklaruar kursime në vitin 2010 nga paga, mbajtur gjendje *cash*.

1.27. Komisioni kreu analizën financiare për vitin 2010 për pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin dhe personat e lidhur, të pasqyruara në tabelën si vijon:

Tabela nr. 3 – Analiza financiare për vitin 2010

Përshkrim	Vlera
Ndryshim likuiditete <i>cash</i>	250,000
Pakësim bono thesari	-650,000
Ndryshim likuiditete bankë	29,110
Total ndryshimi i likuiditeteve	-370,890
Të ardhura nga pagat subjekti	812,196
Të ardhura subjekti nga Shkolla e Magjistraturës (bursa etj.)	13,860
Total të ardhura	826,056
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI – INSTAT	273,240
Shpenzime për tatimin në burim (maturimi i bonove)	5,227
Shpenzime qiraje	58,500
Shpenzime shkollimi vajza në Shqipëri	117,533
Shpenzime për udhëtime nga sistemi TIMS	14,575
Total shpenzime	469,075
Balanca e fondeve (të ardhura - ndryshim likuiditete - shpenzime)	727,870

1.28. Referuar analizës financiare, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme financiare për krijimin e kursimeve në vlerën 250.000 lekë në vitin 2010.

Gjendje cash në shumën 3.100 euro

1.29. Subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2016 ka deklaruar: “*Shumë monetare në 425.000 lekë, kaluar me transfertë bankare në datën 1.2.2016 në llogarinë time në Credins Bank nga S. Z., si ekzekutim i detyrimit lidhur me vendimin nr. ***, datë 7.10.2015, i Gjykatës së Apelit Durrës. Kjo shumë është tërhequr nga llogaria në Credins Bank, është kthyer në euro dhe është mbajtur gjendje cash*”.

1.30. Në vijim, në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur edhe dokumentacionin justifikues²⁴.

1.31. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur prej subjektit të rivlerësimit, rezulton se sipas vendimit nr. ***, datë 7.10.2015, të Gjykatës së Apelit Durrës, në datën 25.8.2013, në plazhin e Durrësit, në pjesën e pasme të një lokali ka rënë zjarr dhe, pasi është përhapur, ka

²⁴ Vendim nr. ***, datë 7.10.2015, i Gjykatës së Apelit Durrës; mandat i tërheqjes së shumës 420.000 lekë në datën 4.3.2016 nga llogaria personale në Credins Bank; kupon për konvertim valute në datën 4.3.2016, nga 420.000 lekë në 3.035 euro.

djegur automjetin tip “Volkswagen Golf 4”, me targë ***²⁵, në pronësi të subjektit, si dhe një automjet tjetër në pronësi të shtetasit N. H.. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit dhe shtetasi N. H. kanë ngritur padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës kundër pronarit të lokalit N. Z., ushtruesit të aktivitetit S. Z. dhe shoqërisë “****” sh.a., duke kërkuar shpërblimin e dëmit solidarisht për automjetet e djegura. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë, duke vendosur detyrimin e shtetasit N. Z. t’i paguajë subjektit 400.000 lekë dhe shtetasit N. H. shumën 350.000 lekë, duke përjashtuar të paditurit e tjerë. Gjykata e Apelit Durrës ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit, me ndryshimin duke vendosur detyrimin solidarisht të shtetasve N. dhe S. Z. për pagimin e dëmit sipas vlerave të mësipërme. Nga verifikimi në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë²⁶ nuk rezulton që kjo çështje të jetë regjistruar për gjykim në këtë gjykatë.

1.32. Referuar lëvizjeve të llogarisë në Credins Bank²⁷, konstatohet se në datën 1.2.2016 shtetasi S. Z. ka kaluar në llogarinë e subjektit të rivlerësimit shumën 425.000 lekë me përshkrimin “Pagesë sipas vendimit të gjykatës nr. ***, datë 7.1.2015”.

1.33. Komisioni vlerëson se këto të ardhura i plotësojnë kriteret e përcaktuara nga ligji për t’u konsideruar si të ardhura të ligjshme, pasi në pikën 9 të nenit 8/1 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, parashikohet se përfitimet për dëmshpërblime, të marra nëpërmjet vendimeve të formës së prerë të gjykatave, si dhe kompensimet e caktuara për kostot gjyqësore, janë të ardhura të përjashtuara nga tatimi mbi të ardhurat personale. Për pasojë, Komisioni pasqyroi shumën 425.000 lekë në seksionin e të ardhurave të vitit 2016.

1.34. Më tej, nga informacioni i përcjellë prej Credins Bank, konstatohet se subjekti i rivlerësimit në datën 4.3.2016 ka tërhequr *cash* shumën 420.000 lekë, me burim të ardhurat e analizuara më lart, dhe kryer konvertimin e kësaj shume në vlerën 3.035 euro, referuar kuponit të këmbimit të valutës të paraqitur nga subjekti²⁸.

1.35. Sa më lart, subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme financiare për krijimin e likuiditeteve *cash* në vlerën 3.100 euro.

1.36. Nga faktet e analizuara më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, lidhur me likuiditetet e deklaruar në deklaratën *Vetting* 2017, në vlerën totale prej 13.200 euro, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime të tjera në lidhje me konstatimin se: *Subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën 366.728 lekë, si rezultat i mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e kursimeve gjatë vitit 2009.*

1.37. Në përgjigje të rezultateve të hetimit²⁹, subjekti i rivlerësimit pranoi pasaktësitë në deklaratat periodike vjetore për mosdeklarimin e saktë të gjendjes *cash* në fund të vitit 2009 dhe vitit 2010, por deklaroi se realisht gjendja *cash* në fund të vitit 2009 ka qenë 500.000 lekë dhe, në fund të vitit 2010, 1.400.000 lekë. Vlera neto e pasurisë e shtuar gjatë këtyre dy viteve, vijoi subjekti i rivlerësimit, është përkatësisht 381.670 lekë dhe 279.110 lekë, që përkon me

²⁵ Analizimi i automjetit me targë *** është bërë në pikën 2 të vendimit.

²⁶ http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Ceshtje_te_Ardhura_26_1-1.php

²⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 25.3.2021.

²⁸ Kupon për konvertim valute datë 4.3.2016, nga 420.000 lekë në 3.035 euro, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit.

²⁹ Email datë 12.6.2023.

një kursim normal nga të ardhurat e saj. Gjithashtu, shpjegon se saktësimi i gjendjes *cash* në ILDKPKI, duke riparuar pasaktësitë mbi gjendjen *cash* në DPV-në e vitit 2009, si dhe të gjitha rrethanat e tjera, përjashtojnë mundësinë e pasjes nga ana e saj të ndonjë qëllimi të kundërligjshëm në drejtim të shmangies së kontrollit të pasurive të saj dhe pasurive të personave të lidhur nga organet e kontrollit periodik apo të kontrollit për efekt të procesit të rivlerësimit.

Arsyetimi ligjor në lidhje me ligjin e zbatueshëm

1.38. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting* 2017; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton si më poshtë:

1.39. Neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, përcakton që deklaratimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitur më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji. Këto deklarata, së bashku me provat e tjera, vlerësohen në tërësi me rrethanat e çështjes, për të arritur në një konkluzion sa më të drejtë. Referuar parashikimit të nenit 4, shkronja “d”³⁰ e ligjit nr. 9049/2003, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin të deklaronte gjendjen reale të likuiditeteve *cash* deri në datën 31.12.2009 e, më pas, deri në datën 31.12.2010.

1.40. Bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit³¹, kursimet në formën e likuiditetit *cash* jashtë sistemit bankar, shtesat dhe pakësimet e tyre merren parasysh nga trupi gjykues sipas deklaratimeve të subjektit dhe personave të lidhur me të në deklaratat periodike/vjetore, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

1.41. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se ka bërë saktësimin e gjendjes *cash* në ILDKPKI, duke riparuar pasaktësitë në DPV-në e vitit 2009, Komisioni arsyeton për sa i takon procesit të vlerësimit të pasurisë, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin. ILDKPKI-ja kontrollon deklaratën e pasurisë dhe i dorëzon Komisionit një raport për ligjshmërinë e pasurive, si dhe për saktësinë dhe plotësinë e deklaratimit. Sipas ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit plotëson deklaratën e pasurisë dhe e dërgon pranë ILDKPKI-së (neni 31), e cila zhvillon një procedurë të plotë kontrolli në përputhje me legjislacionin në fuqi (neni 33). Kjo veprimtari e ILDKPKI-së ka karakter ndihmës në procesin e rivlerësimit, pasi procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve kryhet nga organet e rivlerësimit³².

1.42. Sa më sipër, Komisioni vlerëson se procesverbali i mbajtur në datën 28.10.2016 nga ILDKPKI-ja nuk i shëron pasaktësitë në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në funksion të zbatimit të ligjit nr. 9049/2003.

³⁰ Subjekti ka pasur detyrimin për të deklaruar: “[...] d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në *cash* jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj”.

³¹ Vendimet (JR) nr. 11/2019, në pikën 27.12.18 të paragrafit 27; (JR) nr. 19/2019, në paragrafin 84; (JR) nr. 20/2019, në paragrafin 59 dhe (JR) nr. 29/2019, në paragrafin 31, të Kolegjit.

³² Vendim nr. 2, datë 18.1.2017, i Gjykatës Kushtetuese.

1.43. Për sa kohë që subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pakësim të gjendjes *cash* në shumën 650.000 lekë për vitin 2009 dhe shtesën e së njëjtës shumë në vitin 2010, pretendimi i subjektit për shumën *cash* të disponuar në fund të vitit 2009 e, më pas në vitin 2010, mbetet në nivel deklarativ.

1.44. Sa më sipër, mbetet i pandryshuar konkluzioni se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën 366.728 lekë për kryerjen e shpenzimeve, shtesën në kursime dhe investimin në bono thesari, për periudhën 7.1.2009 – 31.12.2009. Kjo mungesë e burimeve të ligjshme në shumën 366.728 lekë nuk mund të analizohet e vetme, por është vlerësuar në tërësi me rrethanat e çështjes, që janë përcaktuese për vlerësimin e pasurive.

1.45. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën 366.728 lekë për kryerjen e shpenzimeve, shtesën në kursime dhe investimin në bono thesari për periudhën 7.1.2009 – 31.12.2009, duke u gjendur në kushtet e parashikuara në shkronjën “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, e cila është vlerësuar në tërësi me rrethanat e çështjes, që janë përcaktuese për vlerësimin e pasurive.

KONSTATIME TË TJERA

2. Automjet tip “Volkswagen”

2.1. Në DIPP-në e vitit 2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Autoveturë tip “Volkswagen” (vlera e blerjes dhe e doganës), krijuar me të ardhura nga paga dhe kursimet e mëparshme, me vlerë 1.000 euro dhe 31.916 lekë”*.

2.2. Më pas, në DIPP-në e vitit 2013 ka deklaruar: *“Pakësim pasurie në lidhje me automjetin tip “Volkswagen Golf” jo i siguruar nga zjarri dhe djegur plotësisht në datën 25.8.2013 nga një zjarr i rënë aty”*.

2.3. DPSHTRR-ja³³ informon se subjekti ka pasur të regjistruar automjetin me targë ***, i cili sot mban statusin “çregjistrim i përhershëm”. Nga dokumentacioni i përcjellë rezulton se sipas faturës së shitjes të përpiluar në Gjermani, në datën 6.7.2012, subjekti ka blerë automjetin tip “Volkswagen”, vit prodhimi 2002, në shumën 1.000 euro. Sipas deklaratës doganore nr. ***, datë 24.7.2012, automjeti është importuar nga ***, Stuttgart, dhe detyrimet doganore janë përlllogaritur dhe paguar në shumën 34.278 lekë.

2.4. Në dosjen e automjetit figuron vërtetimi nr. *** prot., datë 24.10.2013, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me anë të të cilit vërtetohet se në këtë prokurori janë zhvilluar hetimet në kuadër të akteve me nr. regjistri ***, datë 27.8.2013, për veprën penale “shkatërrim i pronës me zjarr”, të parashikuar nga neni 151 i Kodit Penal dhe hetimet lidhen me ngjarjen e ndodhur në datën 25.8.2013, në zonën e Shkëmbit të Kavajës, ku si pasojë e rënies së zjarrit në lokal “****” janë djegur 3 automjete, midis të cilave automjeti tip “Golf” me targë ***, me pronare shtetasen Alma Kodraliu.

2.5. Sipas vërtetimit të datës 6.11.2013 të DRSHTRR-së Tiranë, automjeti i mësipërm është hequr nga qarkullimi përfundimisht në datën 6.11.2013.

³³ Shkresë nr. *** prot., datë 9.2.2021.

2.6. Nga verifikimi në sistemin elektronik të AMF-së nuk rezulton që subjekti dhe personat e lidhur të figurojnë pronarë apo posedues automjetesh.

2.7. Komisioni kreu analizën financiare për të verifikuar burimet e ligjshme për blerjen e këtij automjeti për periudhën 1.1.2012 – 24.7.2012, për pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, e paraqitur në tabelën si vijon:

Tabela nr. 4 – Analiza financiare në datën 24.7.2012

Përshkrim	Vlera
Autoveturë Volkswagen me targë ***	172,448
Shtesë/pakësim likuiditete <i>cash</i> ³⁴	0
Shtesë/pakësim likuiditete në bankë ³⁵	25,980
Total ndryshimi i likuiditeteve	198,428
Të ardhura nga pagat subjekti ³⁶	508,332
Të ardhura subjekti nga Shkolla e Magjistraturës (bursa etj.) ³⁷	5,400
Total të ardhura	513,732
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI – INSTAT ³⁸	159,122
Shpenzime qiraje ³⁹	63,000
Shpenzime shkollimi vajza në Shqipëri ⁴⁰	47,200
Shpenzime për udhëtime nga sistemi TIMS ⁴¹	9,082
Total shpenzime	278,404
Balanca e fondeve (të ardhura – likuiditete – shpenzime)	36,900

2.8. Referuar analizës financiare, rezulton se subjekti i rivlerësimit figuron me balancë pozitive në vitin 2012 në shumën 36.900 lekë.

2.9. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme financiare për blerjen e automjetit me targë *** në shumën 1.000 euro në vitin 2012.

3. Apartament në Shkodër (blerja, të ardhurat nga qiraja dhe të ardhurat nga shitja)

Lidhur me mënyrën e përfitimit të këtij apartamenti

3.1. Në deklaratën përpara fillimit të detyrës të datës 6.2.2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë “*Apartament banimi me sip. 59 m² në lagjen “***”, rr. “***”, pallati ***, Shkodër, privatizuar në viti 1993. Burimi i krijimit: trashëgimi*”, me pjesë takuese ¼.

3.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting* 2017, si dhe në dokumentacionin e përcjellë nga ZVRPP-ja Shkodër, të administruar nga ILDKPKI-ja⁴², rezulton se me aktin e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. ***, datë 22.6.1993, shtetasit R. K. dhe E. K. kanë blerë nga Sektori i Privatizimit të Banesave

³⁴ Subjekti nuk ka përcaktuar shumën specifike të pakësuar e, për rrjedhojë, nuk është konsideruar si burim.

³⁵ Diferenca midis gjendjes së llogarive bankare në datën 24.7.2012 me atë të datës 31.12.2011.

³⁶ Pagat e kredituara në llogarinë pranë Raiffeisen Bank për periudhën 1.1.2012 – 24.7.2012.

³⁷ Kredituar në llogarinë pranë Raiffeisen Bank në datën 24.7.2012.

³⁸ Në mënyrë përpjesëtimore për periudhën 1.1.2012 – 24.7.2012.

³⁹ Referuar depozitimeve të kryera nga subjekti në llogarinë bankare të qiradhënësës për periudhën 1.1.2012 – 24.7.2012.

⁴⁰ Referuar pagesave të kryera nga subjekti në llogarinë bankare dhe *cash* për periudhën 1.1.2012 – 24.7.2012.

⁴¹ Për periudhën 1.1.2012 – 24.7.2012.

⁴² Shkresë nr. *** prot., datë 3.10.2017.

apartamentin me 1 dhomë e 1 kuzhinë, me sip. 59 m² (nuk lexohet), që ndodhet në pallatin nr. ***, kati ***, lagjja “****”, rruga “****”.

3.3. Sa më lart, rezulton se ky apartament është përfituar me anë të privatizimit.

Të ardhurat nga qiraja

3.4. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga qiraja për periudhën mars 2008 – dhjetor 2008 në shumën 150.000 lekë dhe ka paraqitur dokumentacion justifikues⁴³. Gjithashtu, ka deklaruar se për periudhën e dhënies me qira të banesës përpara muajit mars 2008 nuk ka dokumentacion, pasi kjo marrëdhënie është administruar nga babai pa kontratë, deri në momentin e formalizimit nga ana e subjektit me kontratën nr. ***, datë 26.2.2008.

3.5. Nga hetimi administrativ rezulton se në deklaratën përpara fillimit të detyrës të datës 6.2.2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Qira e banesës në Shkodër për dy vjet e gjysmë në shumën 15.000 lekë”*. Më pas, në DIPP-në e vitit 2009 ka deklaruar: *“Pakësim vlera e qirasë së apartamentit të banimit (meqenëse është shitur)”*.

3.6. Referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, në kontratën e qirasë nr. ***, datë 26.2.2008, pasqyrohet se subjekti i rivlerësimit i ka lëshuar me qira shtetasit E. K. apartamentin e banimit një dhomë e kuzhinë, të ndodhur në Shkodër, lagjja “****”, bulevardi “****”, pallati ***, hyrja ***, kati ***, për një periudhë 10-mujore, duke filluar nga data 1 mars 2008 – 31 dhjetor 2008, me qira mujore në shumën 15.000 lekë.

3.7. Në përgjigje të pyetësorit standard⁴⁴, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Para fillimit të detyrës kam pasur edhe qiranë e banesës së prindërve në Shkodër, ku, pasi babai im ka ndërruar jetë, kam lidhur kontratë qiraje në emrin tim gjatë vitit 2008 për dhjetë muaj, hedhur në llogarinë bankare timen (llogari e mbyllur tashmë)”*.

3.8. Me anë të pyetësorit nr. 1⁴⁵, Komisioni i kërkoi subjektit të shpjegojë nëse motrat e saj kanë përfituar pjesën e tyre takuese nga këto të ardhura, të paraqesë dokumentacion justifikues, si dhe të deklarojë nëse është paguar tatimi në burim. Në përgjigje⁴⁶, subjekti i rivlerësimit deklaroi se asnjë nga motrat e saj nuk ka përfituar nga pjesa e tyre takuese nga qiraja, pasi jo vetëm që kishin hequr dorë nga çdo e ardhur e mundshme nga banesa, por edhe e kanë ndihmuar atë dhe prindërit sa kohë që ka qenë me studime dhe pa një sistemim. Në lidhje me tatimin në burim, shpjegon se nuk ka mundur të gjejë dokumentacion të kohës dhe, për këtë arsye, ka kryer deklarim në vitin 2019 dhe ka paguar tatimin në burim për shumën e përfituar nga qiraja, e cila është përfituar nga ajo sipas kreditimeve në llogarinë bankare.

3.9. Për vërtetimin e këtij deklarimi, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. ***, datë 19.4.2023, të shtetasve A. dhe E. R., ku kjo e fundit deklaroi se nuk ka pasur dhe nuk ka pretendime në lidhje me të ardhurat e përfituara nga dhënia me qira e banesës në bashkëpronësi në Shkodër, e cila është dhënë fillimisht nga babai i saj e, më pas, nga motra Alma, si dhe ka paraqitur deklaratën noteriale nr. ***, datë 18.4.2023, të shtetasës S. H., e cila deklaroi se nuk ka përfituar asnjë vlerë monetare nga qiraja e banesës që kanë pasur në Shkodër, e dhënë me

⁴³ Kontratë qiraje pasurie e paluajtshme nr. ***, datë 26.2.2008; lëvizje llogarie në emër të subjektit pranë Raiffeisen Bank.

⁴⁴ Email datë 1.2.2021.

⁴⁵ Email datë 12.4.2023.

⁴⁶ Email datë 19.4.2023.

qira nga babai i saj R. K. apo motra e saj Alma Kodraliu. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur urdhërpagesën e tatimit në burim të printuar nga sistemi për periudhën tatimore tetor 2019, ku pasqyrohet tatimi mbi qiranë për periudhën tetor 2019 në shumën 22.500 lekë.

Të ardhura nga qiraja

3.10. Për sa i përket të ardhurave nga qiraja të deklaruara të përfituara nga babai i saj, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka përcaktuar vlerën e të ardhurave të përfituara dhe nuk rezulton të jenë paguar detyrimet tatimore për këto të ardhura.

3.11. Nga analizimi i llogarisë bankare të subjektit të rivlerësimit pranë Raiffeisen Bank, u konstatuan depozitime nga palë të treta gjatë periudhës 20.9.2007 – 29.2.2008, konkretisht nga shtetasit B. S., F. S., Xh. S. dhe A. D. në shumën totale 81.000 lekë⁴⁷.

3.12. Lidhur me këto depozitime, në përgjigje të pyetësorit nr. 1⁴⁸, subjekti i rivlerësimit shpjegon se, me sa mban mend, shumat e mësipërme kanë pasur të bëjnë me pagimin e qirasë së banesës në Shkodër, marrëdhënie të cilat i kishte lidhur babai i saj dhe ka qenë po ai i cili merrte dhe administronte qiratë e banesës⁴⁹. Gjithashtu, shpjegon se në kushtet kur babai i saj kishte ndërruar jetë, ajo nuk mund të shkonte çdo muaj për të marrë qiranë dhe, për këtë arsye, qiraja është depozituar në llogarinë e saj bankare. Më pas, vijon shpjegimin se ka lidhur vetë një kontratë qiraje për një periudhë të shkurtër, depozitimi i së cilës është kryer po në llogarinë e saj në Raiffeisen Bank.

3.13. Për sa i përket të ardhurave nga qiraja të deklaruara të përfituara nga subjekti i rivlerësimit, nga analizimi i llogarisë bankare të subjektit të rivlerësimit pranë Raiffeisen Bank, gjatë periudhës 1.3.2008 – 14.1.2009, u evidentuan pagesa nga shtetasi E. K. në vlerën totale 176.500 lekë, përkundrejt vlerës 150.000 lekë të deklaruar nga subjekti.

3.14. Rezulton se detyrimet tatimore janë paguar nga subjekti në vitin 2019, ndërkohë që në pikën 23 të udhëzimit nr. ***, datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së, kërkohet që deklarimi si burim krijimi pasurie i të ardhurave nga qiraja të shoqërohet me vërtetimin përkatës për pagesën e tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga qiraja.

3.15. Komisioni vlerëson se shlyerja me vonesë e detyrimeve tatimore për vitin 2009 pas dorëzimit të deklaratës *Vetting* 2017, tregon për moszbatimin e detyrimit ligjor prej subjektit të rivlerësimit në kohën kur ky detyrim ka lindur. Për pasojë, në referim dhe të jurisprudencës së Kolegjit⁵⁰, shlyerja me vonesë e detyrimeve tatimore nuk e shëron paligjshmërinë e këtyre të ardhurave. Sa më sipër, Komisioni nuk i pasqyroi të ardhurat nga qiraja në analizën financiare.

Të ardhurat nga shitja e apartamentit

3.16. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar vlerën 150.000 lekë (1/12 pjesë takuese) nga shitja e banesës në Shkodër, me kontratën nr. ***, shkurt 2009, në shumën 1.770.059 lekë, si dhe ka paraqitur dokumentacion justifikues⁵¹.

⁴⁷ Për vitin 2007, 4 depozitime në vlerë totale prej 56.000 lekësh dhe për vitin 2008, 2 depozitime me vlerë totale 25.000 lekë.

⁴⁸ Email datë 12.4.2023.

⁴⁹ Subjekti shpjegoi se me sa mban mend, kanë qenë tre studentë që e kishin marrë me qira dhe prandaj pagesat janë kryer nga emra të ndryshëm.

⁵⁰ Vendimet (JR) nr. 7/2019, (JR) nr. 8/2019, (JR) nr. 19/2019, (JR) nr. 5/2020.

⁵¹ Kontratë shitblerjeje pasurie e paluajtshme, nr. ***, shkurt 2009, shitës E., S., E. dhe Alma Kodraliu, të apartamentit me sip. 59 m², ndodhur në Shkodër, shitur në vlerën 1.770.059 lekë + praktika e kontratës; kontratë shitblerjeje pasurie e

3.17. Në DIPP-në e vitit 2009, subjekti ka deklaruar: *“Të ardhura nga shitja e një ap. banimi 1+1 sipas kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.2.2009. E pandarë, në bashkëpronësi në shumën 1.770.059 lekë” me pjesë ideale 1/12”*.

3.18. Rezulton se me vendimin nr. ***, datë 11.2.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, është lëshuar dëshmia e trashëgimisë për shtetasin R. K., ku pasqyrohet se ky shtetas ka ndërruar jetë në datën 26.7.2007 dhe trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë të tij janë bashkëshortja E. K., si dhe fëmijët S. K. (H.), Alma Kodraliu dhe E. K. (R.), të cilët trashëgojnë nga ¼ pjesë takuese.

3.19. Në vijim, me kontratën e shitblerjes nr. ***, shkurt 2009, pa datë, shtetasit E. K., S. H., Alma Kodraliu dhe E. R. apartamentin e lartpërmendur e kanë shitur tek shtetasit H. e F. K. kundrejt çmimit 1.770.059 lekë. Në kontratë parashikohet se blerësit i kanë likuiduar palës shitëse të gjithë vlerën e çmimit të shitjes, pagesë e cila është bërë jashtë zyrës noteriale.

3.20. Ligji nr. 7652/1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, në nenin 20⁵² përcaktonte se në privatizimin e banesave shtetërore merrej për bazë përbërja familjare dhe gjendja e strehimit, që rezulton në regjistrat themeltarë të shtetasve në datën 1.12.1992. Në vijim, Udhëzimi nr. ***, datë 29.1.1993, i Këshillit të Ministrave, në pikën 11⁵³ përcaktonte se banesat që do të privatizohen, regjistrohen në emër të qiramarrësit dhe të pjesëtarëve të tjerë madhorë të familjes së tij dhe pjesëtar madhor quhej personi që është mbi moshën 18 vjeç.

3.21. Referuar të dhënave personale të shitësve në kontratën e shitblerjes nr. ***, shkurt 2009, rezulton se shtetasja S. H. (njëra nga motrat e subjektit) është e vitlindjes 1968 dhe në datën 1.12.1992 kishte mbushur moshën 18 vjeç (24 vjeçe) e, për pasojë, në zbatim të ligjit dhe udhëzimit të sipërpërmendur, pavarësisht se në kontratën e privatizimit nuk figuron si blerëse, gëzonte të drejtën e bashkëpronësisë mbi banesën e privatizuar me 1/3 pjesë, bashkë me prindërit e saj.

3.22. Në këto kushte, bazuar në dëshminë e trashëgimisë, subjekti i rivlerësimit në pasurinë apartament të privatizuar në vitin 1993 i takonte 1/4 e 1/3 pjesë që gëzonte babai i saj. Pra, i takonte 1/12 pjesë e çmimit të shitjes, që i korrespondon vlera 147.504 lekë (1/12 x 1.770.059 lekë), vlerë e cila është pothuajse e barabartë me vlerën e deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting* 2017 (150.000 lekë). Si pasojë, Komisioni pasqyroi vlerën 147.504 lekë në analizën financiare të subjektit, si të ardhura nga pjesa e saj takuese e të hollave të përfituara nga shitja e apartamentit në Shkodër.

3.23. Për sa i përket pjesës takuese të motrave, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në deklaratën *Vetting* 2017 deklaratën e datës 24.11.2009 të shtetasës S. H., nënshkrimi i së cilës është konfirmuar nga noteri po në datën 24.11.2009, në të cilën kjo shtetase ka deklaruar se pjesën e saj takuese në të holla pas shitjes së banesës ia ka dhuruar nënës së saj E. K. dhe se me njëra-tjetrën nuk kanë bërë kontratë për shkak të marrëdhënies nënë e bijë. Po kështu, ka paraqitur deklaratën noteriale nr. ***, datë 19.4.2023⁵⁴, ku shtetasja E. R./motra e subjektit ka deklaruar

paluajtshme, nr. ***, datë 22.6.1993, blerës R. dhe E. K. dhe shitës sektori i privatizimit të banesave; vendim nr. ***, datë 11.2.2008, me objekt “Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë për trashëgimlënësin R. K.”.

⁵² Ligji nr. 7652/1992, neni 20: *“Për efekt të zbatimit të këtij ligji, të merret për bazë përbërja familjare dhe gjendja e strehimit, që rezulton në regjistrat themeltarë të shtetasve në datën 1 dhjetor 1992”*.

⁵³ Udhëzimi nr. ***/1993: *“11. Banesat që do të privatizohen, regjistrohen në emër të qiramarrësit dhe të pjesëtarëve të tjerë madhorë të familjes së tij. Do të quhet pjesëtar madhor personi që është mbi moshën 18 vjeç”*.

⁵⁴ Në përgjigje të pyetësorit nr. 1.

se pas shitjes së banesës në Shkodër ka hequr dorë nga pjesa e saj takuese e të ardhurave të realizuara nga shitja e kësaj banese.

3.24. Sa më lart, Komisioni arrin në përfundimin se nëna e subjektit ka përfituar 11/12 pjesë të çmimit të shitjes, që i korrespondon vlera 1.622.554 lekë (11/12 x 1.770.059 lekë).

3.25. Në përfundim, Komisioni vlerëson se: (i) sa i përket mënyrës së përfitimit të pjesës takuese të subjektit të rivlerësimit në apartamentin e privatizuar në Shkodër nuk konstaton problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016; (ii) lidhur me përfitimin e shumës 150.000 lekë nga shitja e apartamentit, deklarimi i subjektit të rivlerësimit është i saktë në përputhje me ligjin, me burime të ligjshme financiare, duke plotësuar kërkesat e shkronjës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

4. Adresat e banimit

4.1. Komisioni shqyrtoi dhe hetoi deklaratimet e subjektit lidhur me adresat e banimit, me qëllim shuarjen e çdo dyshimi lidhur me të drejta të tjera reale mbi pasuritë e paluajtshme të deklaruara si banesë.

4.2. Lidhur me adresat e banimit të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratimet periodike vjetore dhe në përgjigje të pyetësorit standard⁵⁵ nga hetimi administrativ rezultoi si më poshtë:

4.3. Lidhur me adresën e banimit në periudhën 2003 – tetor 2006⁵⁶, subjekti i rivlerësimit, në DIPP-të vjetore ka deklaruar apartament në lagjen “****”, blv. “****”, pallati ***, Shkodër, që përkon me apartamentin e privatizuar nga prindërit e subjektit në vitin 1993, që është trajtuar në pikën 3 të vendimit.

4.4. Lidhur me adresën e banimit në periudhën tetor 2006 – qershor 2010, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit standard, ka deklaruar se kur ka kryer deklarinimin fillestar si gjyqtare ka deklaruar rruga “****”, pallati ***, shkalla ***, Njësia Nr. ***, Tiranë, dhe kjo banesë ka qenë në pronësi të motrës së saj E. dhe bashkëshortit të saj, z. A. R., të cilët kanë jetuar në të nga momenti i blerjes deri kur e kanë shitur. Më pas, subjekti ka deklaruar se nga tetori 2006, kur ka filluar Shkollën e Magjistraturës, ka banuar bashkë me familjen e motrës së saj deri sa është emëruar përfundimisht dhe është transferuar në Pogradec. Që nga ai moment, vijon subjekti i rivlerësimit, nuk ka banuar më tek kjo banesë, pavarësisht se e ka deklaruar si adresë banimi zyrtare. Gjithashtu, shpjegon se me qëllim transferimin e gjendjes civile në Tiranë, ka lidhur me bashkëshortin e motrës/A. R. kontratën e qirasë nr. *** rep., datë 14.11.2007, për periudhën 1.11.2007 – 1.11.2008, por në fakt nuk ka paguar qira. Për vërtetimin e këtij deklarimi ka paraqitur kontratën e qirasë nr. *** rep., datë 14.11.2007⁵⁷.

Lidhur me banimin e prindërve pas transferimit në Tiranë, subjekti ka deklaruar se prindërit e saj kanë banuar me motrën e madhe S. H. dhe pasi është transferuar në Pogradec nëna e saj ka qëndruar tek të dyja motrat, herë tek njëra herë tek tjetra. Pasi ka ardhur në Tiranë në vitin

⁵⁵Nga analizimi i deklaratimeve të subjektit në DIPP-të vjetore dhe në pyetësorin standard rezulton se subjekti ka banuar në këto adresa: (i) 2003 – tetor 2006, lagjja “****”, blv. “****”, p. ***, Shkodër; (ii) tetor 2006 – qershor 2010, rruga “****”, p. ***, shkalla ***, Njësia Nr. ***, Tiranë; (iii) qershor 2010 – 14.9.2010, tek motra e vogël E. R. (rruga “****”, p. ***, shkalla ***, Njësia Nr. ***, Tiranë)⁵⁵; (iv) 15.9.2010 – prill 2013, Lagjja Nr. ***, p. ***, ap. ***, Pogradec; (v) prill 2013 – fundi i vitit 2014, Njësia Nr. ***, rruga “****”, p. ***, Tiranë; (vi) fundi i vitit 2014 e në vazhdim, rruga “****”, p. ***, ***, kati ***, apartamenti nr. ***, Tiranë.

⁵⁶ Gjatë së cilës ushtronte detyrën e oficerit të policisë gjyqësore.

⁵⁷ Protokolluar me nr. *** prot., datë 1.2.2021.

2013, vijon subjekti, diku nga vjeshta, nëna e saj ka filluar të banojë në adresën ku qëndron aktualisht edhe sot dhe nuk kanë lëvizur që nga ajo kohë.

Sipas dokumentacionit të përcjellë nga DPGJC-ja⁵⁸, rezulton se ZGJC Shkodër informon se subjekti dhe vajza e saj I. Ç. janë shpërngulur në Njësinë nr. ***, Tiranë, në datën 27.2.2008, ndërsa ZGJC-ja Nr. ***, Tiranë, informon se familja ka ardhur nga Shkodra në datën 26.12.2007.

Nga shqyrtimi i kontratës së qirasë nr. *** rep., datë 14.11.2007, rezulton se subjekti në cilësinë e qiramarrësit ka marrë me qira një dhomë në apartamentin në pronësi të qiradhënësit, shtetasit A. R., me adresë rruga "****", pallati ***, shk. ***, ap. ***, me sip. 112 m², kundrejt qirasë në shumën 10.000 lekë, për një afat 1-vjeçar, 1.11.2007 – 1.11.2008.

Në përgjigje⁵⁹ të pyetësorit nr. 1, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacionin që provon pronësinë e banesës nga ana e motrës së saj E. R. dhe bashkëshortit të saj, si dhe dokumentacionin që provon se ka jetuar në këtë banesë pa kundërshpërblim⁶⁰.

Sa më sipër, nuk konstatohet ndonjë rrethanë apo e dhënë që lidhet me gëzimin e ndonjë të drejte reale të subjektit mbi pasurinë e mësipërme.

4.5. Lidhur me adresën e banimit në periudhën qershor 2010 – shtator 2010, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit standard, ka deklaruar se ka banuar në banesën e motrës E. R. deri në emërimin përfundimtar dhe transferimin në Pogradec dhe se në datën 15.9.2010 ka lidhur një kontratë qiraje me qiradhënësin L. M., për një banesë në Pogradec.

Nga hetimi administrativ rezulton se subjekti është caktuar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec me dekretin e datës 25.6.2010. Në vijim, Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 1⁶¹, i kërkoi subjektit të deklarojë se ku ka jetuar nga momenti i emërimit (qershor 2010) deri më 15.9.2010, duke specifikuar edhe kostot mujore, si dhe të paraqesë dokumentacion justifikues. Në përgjigje⁶², subjekti i rivlerësimit deklaroi se nga qershori 2010 deri në shtator 2010 ka vijuar të qëndrojë tek motra e vogël E. R. (rruga "****", pallati ***, shkalla ***, Njësia Nr. ***, Tiranë) dhe në Pogradec ka shkuar e ardhur brenda ditës me furgon, nisur nga fakti se nuk kishte ngarkesë të madhe në punë. Me marrjen e banesës me qira në Pogradec, deklaroi se është transferuar aty së bashku me vajzën.

Sa më sipër, Komisioni nuk konstaton problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit lidhur me deklarimin e adresës së banimit nga subjekti i rivlerësimit për periudhën qershor – shtator 2010.

4.6. Lidhur me adresën e banimit në periudhën shtator 2010 – prill 2013, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit standard, ka deklaruar se në datën 15.9.2010 ka lidhur kontratën e qirasë nr. ***, me shtetasen L. M. për apartamentin e ndodhur në pallatin ***, nr. ***, kati ***, Lagjja nr. ***, Pogradec, duke parapaguar qiranë për 6 muaj e gjysmë dhe se qiraja është

⁵⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 10.3.2023.

⁵⁹ Email 19.4.2023; dokumente të protokolluara në Komision me nr. *** prot., datë 19.4.2023.

⁶⁰ Kontratën e shitjes datë 24.12.2003, ku pasqyrohet se shtetasi A. R. ka blerë nga shoqëria "****" sh.p.k. apartamentin e ndodhur në godinën 12 kate në rrugën "****", kati i 2-të, i përbërë nga 2 dhoma, një kuzhinë dhe ambiente ndihmëse, sip. 104.39 m²; deklaratën noteriale nr. ***, datë 19.4.2023, të shtetasve A. dhe E. R., të cilët kanë deklaruar se gjatë periudhës së magjistraturës, Alma Kodraliu ka qëndruar në banesën e tyre në rrugën "****" dhe se nuk ka paguar qira pavarësisht se shtetasi A. R. kishte lidhur kontratë qiraje me Alma Kodraliu, për shkak të marrëdhënieve të posaçme.

⁶¹ Email datë 12.4.2022.

⁶² Email datë 19.4.2023.

depozituar në Tirana Bank në llogarinë e kësaj shtetaseje. Për vërtetimin e këtij deklarimi subjekti ka paraqitur dokumentacionin provues⁶³.

Nga shqyrtimi i kontratës së qirasë nr. ***, datë 15.9.2010, rezulton se subjekti ka marrë me qira apartamentin në pronësi të shtetases L. M. të ndodhur te pallati nr. ***, nr. ***, kati ***, Lagjja nr. ***, Pogradec, me sip. 60 m², me afat 1-vjeçar për periudhën 15.9.2010 – 15.9.2011, kundrejt çmimit të qirasë prej 9.000 lekësh dhe se likuidimi i qirasë do të bëhet njëherësh për 6 muaj e gjysmë *cash* dhe shuma tjetër do të likuidohet çdo muaj pasardhës në llogarinë e qiradhënëses.

Referuar dokumentacionit të administruar nga Tirana Bank⁶⁴, rezulton se në llogarinë e shtetases L. M. janë depozitime periodike nga ana e subjektit, përgjatë periudhës prill 2012 – maj 2013, me përshkrimin “Depozitim *cash* qira”.

Sa më lart, Komisioni pasqyroi në analizën financiare shpenzimet e qirasë në një vlerë totale prej 292.500 lekësh⁶⁵, për periudhën e qëndrimit në qytetin e Pogradecit.

Komisioni hetoi lidhur me konfliktin e interesit të subjektit me shtetasen L. M. dhe me bashkëshortin e saj V. M. dhe nuk rezultoi që subjekti të ishte në kushtet e konfliktit të interesit me këta shtetas⁶⁶.

Sa më sipër, Komisioni nuk konstaton problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit lidhur me adresën e banimit të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit për periudhën shtator 2010 – prill 2013.

4.7. Rezulton se në DIPP-në e vitit 2012 subjekti ka deklaruar si adresë të gjendjes civile: “*Rruga “***”, pallati ***, Njësia Bashkiake Nr. ***, Tiranë*”. Në vijim, në pyetësorin standard ka shpjeguar se në njërin nga vitet e deklarimit ka shënuar gabim adresën zyrtare, për shkak se ishte mjaftuar me adresën e dhënë nga motra në lidhje me vendbanimin e saj, vendbanim të cilin ajo e kishte ndryshuar.

Në përgjigje të pyetësorit nr. 1⁶⁷, subjekti i rivlerësimit shpjegon se në DIPP-në e vitit 2012, gabimisht ka vënë adresën e re të motrës së vogël E. R., për shkak se nuk kishte mbajtur kopje të deklaratave të pasurisë, të cilat i ka marrë pas deklaratës *Vetting* dhe pasi ka pyetur motrën për adresën ajo i ka dhënë adresën në të cilën jetonin në atë vit, atë në rrugën “***”. Subjekti shpjegoi se ka deklaruar atë adresë duke menduar se ajo ishte edhe adresa e saj në ZGJC, ndërkohë që më vonë është kujtuar që adresa e re e motrës nuk përputhej me atë në të cilën ishte regjistruar në ZGJC. Për këtë arsye, një vit më vonë, në DIPP-në e vitit 2013 ka deklaruar si adresë gjendjen civile në rrugën “***”, siç ishte e regjistruar në gjendjen civile, përfundoi subjekti.

Për të provuar deklaratimet e saj, subjekti i rivlerësimit paraqiti kopje të kontratës së shitjes nr. ***, datë 15.10.2012, sipas së cilës shtetasit A. dhe E. R. e kanë shitur apartamentin në rrugën

⁶³ Kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.9.2010 dhe kopje të librezës së depozitës në emër të shtetases L. M.

⁶⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 11.4.2023.

⁶⁵ Në vitin 2010, vlera 58.500 lekë, *cash*, parapagim për 6 muaj e gjysmë; në vitin 2011, vlera 81.000 lekë; në vitin 2012, vlera 108.000 lekë; në vitin 2013, vlera 45.000 lekë.

⁶⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 18.4.2023, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

⁶⁷ Email datë 19.4.2023.

“****” dhe kopje të kontratës së shitjes nr. ***, datë 9.5.2012, sipas së cilës shtetasi A. R. ka blerë apartamentin e ndodhur në rrugën “****”, shk. ***, Tiranë⁶⁸.

Komisioni vëren se gabimi në deklarimin e adresës në DIPP-në e vitit 2012 ka ndodhur pikërisht në vitin që motra e subjektit ka shitur banesën në rrugën “****” dhe ka blerë atë në rrugën “****”, e provuar kjo me kontratat e paraqitura.

Sa më lart, Komisioni nuk konstaton problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit lidhur me deklarimin e subjektit të rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2012 të adresës “*Rruga “****”, pallati ***, Njësia Bashkiake Nr. ***, Tiranë*”.

4.8. Lidhur me adresën e banimit në periudhën prill 2013 – fundvit 2014, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit standard, ka deklaruar se kur ka marrë lejen dhe është emëruar si ndihmëse ligjore në Gjykatën e Lartë⁶⁹ ka jetuar te motra e saj e madhe S. H., në rrugën “****”, duke sqaruar se kjo banesë është në pronësi të motrës dhe bashkëshortit të saj, S. dhe N. H., dhe se ka jetuar bashkë me familjen e motrës deri nga fundi i vitit 2014.

Në përgjigje të pyetësorit nr. 1⁷⁰, subjekti i rivlerësimit paraqiti kopje të kontratës së shitjes nr. ***, datë 29.12.2000, në të cilën pasqyrohet se shtetasi N. H. ka blerë nga shoqëria “****” sh.p.k. apartamentin e ndodhur në rrugën “****”, me sipërfaqe ndërtimi 130 m².

Sa më lart, Komisioni nuk konstaton problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit lidhur me deklarimin nga subjekti i rivlerësimit të adresës së banimit në *Njësinë nr. ***, rruga “****”, pallati ***, Tiranë*.

4.9. Lidhur me adresën e banimit në periudhën fundvit 2014 e në vazhdim, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit standard, ka deklaruar se nga fundi i vitit 2014, së bashku me vajzën është transferuar në garsonierën ku qëndronte nëna e saj, në pronësi të shtetases S. A., me sip. 54 m², të ndodhur në rrugën “****”, pallati ***, ***, k. ***, ap. ***, Tiranë. Gjithashtu, ka deklaruar se gjatë vitit 2015 nuk ka pasur kontratë qiraje të shkruar me qiradhënësen S. A., por ka paguar qiranë për këtë vit me marrëveshje verbale, nisur nga fakti që njiheshin dhe, më tej, në vitin 2016 ka lidhur kontratë qiraje me të njëjtat kushte si në vitin paraardhës. Për vërtetimin e deklarimit subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kontratën e qirasë datë 5.1.2016, si dhe kopje të deklaratës së datës 18.10.2016 të shtetases S. A..

Referuar kontratës së qirasë datë 5.1.2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka marrë me qira apartamentin tip garsoniere, në pronësi të shtetases S. A., në rrugën “****”, për një periudhë 1-vjeçare, duke filluar nga data 5.1.2016, me vlerë qiraje mujore 17.300 lekë. Bashkëlidhur kontratës gjendet kopja e certifikatës së pronësisë së pasurisë apartament me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, Tiranë, në pronësi të shtetases S. A., si dhe kopja e kartelës.

Në deklaratën e datës 18.10.2016, shtetasja S. A. ka deklaruar se ka nënshkruar kontratë qiraje me znj. Alma Kodraliu me vlerë mujore 17.300 lekë, me efekt nga data 1.1. 2016 dhe në formularin e deklarimit të të ardhurave personale ka llogaritur të ardhura nga qiraja për këtë kontratë shumë 207.600 lekë, për të cilat ka deklaruar detyrimin tatimor në masën 31.140 lekë.

⁶⁸ Ap. ***, me sip. 126 m², i regjistruar në ZVRPP Tiranë me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, kundrejt çmimit 150.000 euro.

⁶⁹ Vendimi i KLD-së është i datës 3.5.2013, ndërsa detyrën e ka ushtruar në periudhën 6.5.2013 – 3.5.2016.

⁷⁰ Email datë 19.4.2023.

Komisioni konstatoi se në DIPP-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar: “Shpenzime të kryera për qira banese me sip. 52.4 m² (garsoniere) në adresën rruga “***”... Shuma mujore e paguar 20.000 lekë, pa kontratë të shkruar”.

Në kushtet kur shuma e qirasë mujore e deklaruar në DIPP-në e vitit 2015 nuk përputhet me shumën e përcaktuar në kontratën e qirasë, Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 1⁷¹, i kërkoi subjektit të japë shpjegime lidhur me këtë mospërputhje, si dhe të paraqesë dokumentacion nga qiradhënësi për të provuar marrëdhënien e qirasë gjatë vitit 2015. Në përgjigje⁷², subjekti deklaroi se në vitet 2015 dhe 2016 i është paguar shtetas S. A. shuma 20.000 lekë, ndërsa vlera 173.000 lekë është shuma neto e qirasë që përfitonte znj. A.

Për të provuar marrëdhënien e qirasë në vitin 2015, në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka kërkuar që qiradhënësjë të lëshojë një deklaratë në lidhje me ekzistencën e marrëdhënies së qirasë gjatë vitit 2015, por nuk ka qenë e mundur. Në këto kushte shpjegon se u detyrua t’u marrë nga një deklaratë noteriale⁷³ dy banorëve të pallatit, shtetasve I. G. dhe M. Ç.⁷⁴, që konfirmojnë deklaratimet e saj. Nga ana tjetër, marrëdhëniet e qirasë identifikohet edhe në deklarinimin e vitit përkatës, për të njëjtin objekt banimi, përfundoi subjekti.

Nga informacioni i administruar nga FSHU-ja⁷⁵ dhe UKT-ja⁷⁶ nuk rezultoi që në emër të subjektit, vajzës së saj dhe prindërve të saj të ekzistojë ndonjë kontratë furnizimi. Në procesverbalin e datës 28.10.2016, të ILDKPKI-së, lidhur me pyetjen se si e shpjegonte faktin që në emrin e saj nuk ekzistojnë kontrata me OSHEE-në, subjekti ka sqaruar se nuk ka asnjë kontratë, pasi janë në emër të pronarëve të shtëpisë dhe nuk ka shtëpi në pronësi.

Nga dokumentacioni i përcjellë nga DPGJC-ja⁷⁷, rezultoi se ZGJC Tiranë informoi se subjekti dhe vajza e saj kanë ndryshuar vendbanimin nga Njësia Nr. *** në Njësinë Nr. *** në datën 26.7.2017.

Sa më lart, Komisioni pasqyroi në analizën financiare të viteve 2015 dhe 2016 shpenzime qiraje në vlerën 240.000 lekë/vit.

Komisioni hetoi lidhur me konfliktin e interesit të subjektit me shtetasen S. A. dhe të bashkëshortit të saj H. A. Nga informacioni i administruar⁷⁸ nuk rezultoi që subjekti të jetë në kushtet e konfliktit të interesit me këta shtetas.

Sa më sipër, Komisioni nuk konstatoi problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit lidhur me deklarinimin nga subjekti i rivlerësimit të adresës së banimit në rrugën “***”, pallati ***, 1/2, k. ***, ap. ***, Tiranë.

4.10. Në përfundim, Komisioni vlerëson se: (i) deklarimi i subjektit të rivlerësimit lidhur me adresat e banimit është i mbështetur në dokumentacionin justifikues; (ii) nuk konstatohen

⁷¹ Email datë 12.4.2023.

⁷² Email datë 19.4.2023.

⁷³ Nr. ***, datë 26.4.2023 dhe nr. ***, datë 26.4.2023.

⁷⁴ Banori që përgjigjej edhe për mbledhjen e detyrimeve dhe administrimin e pallatit.

⁷⁵ Shkresat nr. *** prot., datë 16.2.2021 dhe nr. *** prot., datë 15.3.2023.

⁷⁶ Shkresat nr. *** prot., datë 10.2.2021 dhe nr. *** prot., datë 20.3.2023.

⁷⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 10.3.2023.

⁷⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 2.5.2023, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

rrethana apo të dhëna që lidhen me gëzimin e ndonjë të drejte tjetër reale nga ajo e banimit mbi pasuritë e deklaruar si adresa banimi nga subjekti i rivlerësimit.

PASURITË E VAJZËS SË SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT/I. Ç.

5. Shuma prej 9.013 euro në Deutsche Bank, Berlin

5.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, personi i lidhur/I. Ç. ka deklaruar: “*Shuma prej 9.013 euro (gjendje në datën 14.10.2016), ndodhur në D. Bank, Berlin, në nr. e llogarisë *** euro. Kjo shumë është krijuar si rrjedhojë e transferimit në llogarinë time në Raiffeisen Bank të shumës 9.965 euro nga llogaria e gjyshes sime E. K., në BKT dega Tiranë, me qëllim mbulimin e studimeve të mia. Në datën 23.1.2017 gjendja e kësaj llogarie (e cila zbritet çdo muaj) është në shumën 4.916 euro*”. Në seksionin “Të dhëna konfidenciale”, personi i lidhur ka deklaruar: “*Shuma prej 9.965 euro, kaluar në llogarinë time në Raiffeisen Bank nga gjyshja ime E. K., me qëllim mbulimin prej saj të shpenzimeve të mia të studimeve është krijuar nga shitja e banesës në Shkodër, me kontratën e shitjes nr. ***, shkurt 2009. Pas shitjes së shtëpisë këtë vlerë gjyshja ia ka dhënë hua tezes sime S. H., e cila ia ka kthyer me shitjen më vonë të banesës së saj në Durrës dhe është depozituar kjo shumë në llogarinë e gjyshes sime në BKT, dega Tiranë*”. Për vërtetimin e deklaramit, subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues⁷⁹.

5.2. Referuar informacionit të përcjellë nga Raiffeisen Bank⁸⁰, në datën 26.7.2016, në llogarinë e vajzës së subjektit të rivlerësimit është kredituar shuma 9.965 euro me përshkrimin “E. H. K., transfertë në llogarinë e mbesës për mbulimin e shpenzimeve të studimeve”. Më tej, në datën 15.9.2016, nga kjo llogari është transferuar shuma 329,39 euro në favor të “**** Berlin”, me përshkrimin “I. I. Ç. *** Berlin” dhe në datën 27.9.2016 është transferuar në favor të llogarisë së vajzës së subjektit të rivlerësimit pranë *** Bank në Gjermani shuma 9.631 euro, me përshkrimin “Funds transfer for school”.

5.3. Nga analizimi i lëvizjeve të llogarisë së vajzës së subjektit të rivlerësimit pranë *** Bank⁸¹, konstatohet se në datën 29.9.2016 është kredituar shuma 9.593,63 euro (shuma e transferuar nga llogaria bankare në Shqipëri, pas zbritjes së komisioneve).

5.4. Në datën e plotësimit të deklaratës *Vetting* 2017⁸², teprica e llogarisë pranë *** Bank paraqitet me vlerën 4.781,28 euro⁸³, ndërsa llogaria pranë Raiffeisen Bank rezulton me gjendje 0 (zero).

5.5. Në kushtet kur personi i lidhur/I. Ç. ka deklaruar se gjyshja e saj/nëna e subjektit të rivlerësimit, znj. E. K., ka kontribuar në mbulimin e studimeve të saj në shumën 9.965 euro dhe ky fakt vërtetohet nga lëvizjet në llogarinë bankare të personit të lidhur, bazuar në pikën 14 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, shtetasja E. K. konsiderohet “person tjetër i lidhur” dhe, si pasojë, në zbatim të pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës së dhënë nga shtetasja E. K. vajzës së subjektit të rivlerësimit.

⁷⁹ Transfertë llogarie datë 22.7.2016, e BKT-së; nxjerrje llogarie e datës 19.9.2016 nga Raiffeisen Bank për shtetasen I. Ç.; deklaratë e datës 24.11.2009, e shtetasës S. H.; nxjerrje llogarie E. K. nga BKT-ja, datë 14.10.2016; nxjerrje llogarie N. H. datë 17.10.2016.

⁸⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 16.2.2021.

⁸¹ Paraqitur nga subjekti në datën 2.5.2023, bashkëlidhur përgjigjeve shtesë të pyetësorit nr. 2.

⁸² Datë 26.1.2017.

⁸³ Teprica e llogarisë pranë *** Bank në datën 31.12.2016 paraqitet me vlerën 5.696,21 euro, vlerë e cila u pasqyrua si gjendje likuiditeti për efekt të analizës financiare të vitit 2016.

Analizimi i burimit të shumës së dhuruar prej 10.000 euro

5.6. Nga analizimi i dokumentacionit të administruar dhe shpjegimeve të subjektit, rezulton se janë kryer transaksionet vijuese:

- i. Në shkurt 2009, subjekti i rivlerësimit së bashku me nënën dhe dy motrat e saj kanë shitur një apartament në qytetin e Shkodrës, në vlerën 1.770.059 lekë. Më tej, motrat e subjektit, S. H. dhe E. R., i kanë falur nënës së tyre pjesën e tyre takuese të të ardhurave të realizuara nga shitja e këtij apartamenti (referuar trajtimit në paragrafin 3.24 të vendimit, është konkluduar se nëna e subjektit ka përfituar në total shumën 1.622.554 lekë).
- ii. Në datën 24.11.2009, motra e subjektit të rivlerësimit/S. H. i ka marrë hua nënës së saj të hollat që kjo e fundit ka përfituar nga shitja e apartamentit të sipërcituar, përfshirë pjesën që i kanë falur vajzat. Referuar deklaratës datë 24.11.2009 të shtetases S. H., nënshkrimi i së cilës është konfirmuar nga noteri në të njëjtën datë, kjo shtetase ka deklaruar se për shkak se i janë dashur të hollat, i ka marrë hua pa asnjë interes nënës së saj shumën 10.000 euro, të cilën do t'ia kthejë kur mbesa e saj/I. Ç. të mbushë 18 vjeç⁸⁴.
- iii. Në datën 25.1.2016, motra e subjektit të rivlerësimit/S. H. dhe bashkëshorti i saj kanë shitur një apartament në ***, Durrës, në vlerën 31.200 euro, e provuar me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 25.1.2016⁸⁵.
- iv. Në datën 29.1.2016, në llogarinë bankare të shtetasit N. H. (bashkëshorti i motrës së subjektit) pranë Alpha Bank⁸⁶, është transferuar shuma 31.200 euro me përshkrimin “*** person fizik për N. H. kalim sipas kontratës së shitblerjes me nr. pas ***, z. k. ***”. Më tej, në datën 16.2.2016, shtetasi N. H. ka tërhequr shumën 10.000 euro me përshkrimin “Tërheqje N. H.”. Në të njëjtën datë, ai e ka depozituar këtë vlerë në llogarinë e nënës së subjektit/E. K. në BKT me përshkrimin “N. H. derdh në llogari të E. H. K. likuidim detyrimi”, referuar informacionit të përcjellë nga BKT-ja⁸⁷, të paraqitur edhe nga subjekti.
- v. Në datën 22.7.2016, nëna e subjektit të rivlerësimit ka transferuar në llogarinë e mbesës së saj/vajzës së subjektit, shumën 10.000 euro, me përshkrimin “Transfertë në llogarinë e mbesës për mbulimin e shpenzimeve të studimeve”, referuar informacionit të përcjellë nga BKT-ja⁸⁸, të paraqitur edhe nga subjekti.

5.7. Sa më lart, Komisioni vëren se deklaratimet e subjektit mbi origjinën e krijimit të shumës 10.000 euro përputhen me dokumentacionin e administruar. Për pasojë, Komisioni çmon se nëna e subjektit të rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme financiare për dhënien hua vajzës së saj/S. H. (nga shitja e apartamentit në Shkodër) dhe kjo e fundit ka pasur burime të ligjshme financiare për kthimin e huas nënës së saj/E. K. (nga shitja e apartamentit në Durrës), fonde të cilat i janë dhuruar vajzës së subjektit të rivlerësimit/I. Ç.

5.8. Në përfundim, Komisioni vlerëson se: (i) deklarimi i subjektit të rivlerësimit përputhet me dokumentacionin e administruar; (ii) personi tjetër i lidhur/nëna e subjektit ka pasur burime

⁸⁴ Paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting* 2017.

⁸⁵ Paraqitur nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 1, kopje të kontratës së shitblerjes pasuri e paluajtshme nr. ***, datë 25.1.2016, në të cilën pasqyrohet se shtetasi N. H. dhe S. H. kanë shitur apartamentin me nr. pasurie ***, të ndodhur në z. k. ***, vol. ***, f. ***, Lagjja nr. ***, ***, Durrës, me sip. 62 m² kundrejt çmimit 31.200 euro.

⁸⁶ Referuar lëvizjeve të llogarisë bankare pranë Alpha Bank, të paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting*. Diferenca prej 21.200 euro është tërhequr në datën 17.2.2016.

⁸⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 20.4.2023.

⁸⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 20.4.2023.

financiare të ligjshme për dhurimin e shumës 10.000 euro mbesës së saj/I. Ç., vajzës së subjektit të rivlerësimit, në vitin 2016, duke plotësuar kriteret e parashikuara në shkronjën “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

6. Shpenzimet e shkollimit në Gjermani të vajzës së subjektit të rivlerësimit

6.1. Në pyetësonin standard subjekti ka deklaruar: *“Në lidhje me studimet në Universitetin *** të Berlinit të vajzës sime I. Ç., është shpenzuar: shpenzimet e Universitetit për një semestër janë 307 euro. Nga të dhënat e llogarisë së vajzës sime në Berlin, në *** Bank rezultojnë edhe pagesat e universitetit dhe të jetesës; në datën 27.6.2016, në llogarinë në *** Bank është kaluar shuma 9.633 euro, shumë të cilën e kam deklaruar e ka financuar nëna ime dhe e kam sqaruar në përgjigjen e pyetjes nr. 4, shumë e cila është përdorur për vitin e parë të studimeve”.*

6.2. Më tej, në pyetësonin nr. 1⁸⁹, subjekti ka shpjeguar për sa i takon shpenzimit të semestrit të parë të shkollës, ai është paguar që në Shqipëri përpara vajtjes dhe kjo mund të verifikohet në *statement*-in e llogarisë së vajzës në Raiffeisen Bank, në pagesën e kryer në datën 15.9.2016, në shumën 329,39 euro, në drejtim të *** Berlin. Semestri tjetër është paguar në janar 2017. Gjithashtu, subjekti ka përcjellë një link të këtij universiteti (<https://www.tu.berlin/go25260/>) dhe ka sqaruar se aty pasqyrohen tarifat e këtij universiteti në vite.

6.3. Për sa i përket tarifës së shkollimit, nga këqyrja e llogarive bankare, vërehet se: (i) në datën 15.9.2016, nga llogaria e vajzës së subjektit pranë Raiffeisen Bank⁹⁰ janë transferuar 329,39 euro në favor të “*** Berlin”, me përshkrimin “I. I. *** Berlin ***” (përfshirë komisionet për transfertën ndërkombëtare në shumën 26 euro); (ii) në datën 20.1.2017, nga llogaria e vajzës së subjektit pranë *** Bank janë transferuar 307 euro në favor të Universitetit *** të Berlinit.

6.4. Komisioni konstaton se të dyja shumat e sipërcituara përkojnë me tarifat që evidentohen në faqen zyrtare të internetit të Universitetit *** të Berlinit⁹¹.

6.5. Për sa i përket shpenzimeve të qëndrimit, nga këqyrja e llogarisë së vajzës pranë *** Bank në Gjermani, përgjatë periudhës 26.9.2016 – 31.12.2016 vërehet se: (i) janë kryer dy transfertat për pagesën e qirasë në vlerë totale 770,98 euro⁹²; (ii) është kryer një pagesë me vlerë 600 euro me përshkrimin “***”; (iii) janë pagesa të ndryshme në vlerën totale 1.148 euro; (iv) tërheqje *cash* nga llogaria në shumën 1.550 euro. Në total rezulton një shpenzim prej 4.069 euro.

6.6. Në përgjigje të pyetësonit nr. 2⁹³, subjekti shpjegoi se gjatë periudhës 22.9.2016 (data e mbërritjes në Gjermani) – 31.10.2016, vajza e saj së bashku me shoqet kanë qëndruar në banesën për të cilën lidhën kontratën e qirasë në datën 1.11.2016. Fillimisht, në këtë banesë jetonte shtetasi D. M., i njohuri i njëres prej shoqeve të vajzës së subjektit, të cilit iu pagua vlera e qirasë për këtë periudhë⁹⁴, si edhe garancia/paradhënia e paguar më parë nga ana e tij⁹⁵.

6.7. Në vijim, Komisioni krahasoi shpenzimet totale të kryera nga vajza e subjektit të rivlerësimit me të dhënat statistikore për shpenzimet jetike gjatë vitit 2016 për një person në

⁸⁹ Shpjegimet shtesë përcjellë me nr. *** prot., datë 2.5.2023.

⁹⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 16.2.2021.

⁹¹ Semestër ***, vlerë totale 303,39 euro dhe semestër ***, vlerë totale 306,99 euro.

⁹² Në pyetësonin nr. 1 (përgjigjet e datës 2.5.2023), subjekti ka paraqitur: (i) kontrata e qirasë e lidhur me *** (jo të gjitha faqet), (ii) komunikimet me *email* të vajzës së subjektit për këtë kontratë; (iii) lëvizjet e llogarisë pranë *** Bank për periudhën 26.9.2016 – 31.12.2016. Në datën 9.11.2016, vlera 385,49 euro dhe në datën 2.12.2016, vlera 385,49 euro.

⁹³ Datë 9.5.2023.

⁹⁴ Subjekti shpjegoi se për pagesën e qirasë janë tërhequr lekë në bankë, pasi i janë dhënë *cash* shtetasi D. M.

⁹⁵ Pjesa e vajzës është paguar me transfertë bankare në datën 2.12.2023.

Gjermani⁹⁶, ku këto të fundit rezultuan në vlerën 12.765 euro/vit. Për periudhën e qëndrimit në Gjermani shpenzimet u përlogaritën në vlerën 3.478 euro⁹⁷, pra më të ulëta se shpenzimet e kryera nga vajza e subjektit të rivlerësimit, në total 4.069 euro.

6.8. Komisioni paraqiti në analizën financiare të vitit 2016 shpenzime për shkollimin dhe qëndrimin në Gjermani të vajzës një vlerë totale prej 4.398 euro⁹⁸.

6.9. Nga analiza financiare rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të mjaftueshme të ligjshme financiare për mbulimin e shpenzimeve të shkollimit në Gjermani të vajzës së saj.

7. Analiza financiare

7.1. Komisioni kreu analizën financiare duke konsideruar pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e rivlerësimit dhe vajzën për periudhën 1999 – 2014⁹⁹ dhe, në vijim, për periudhën 2015 – 2016, duke përfshirë në këtë të fundit edhe nënën e subjektit të rivlerësimit.

Tabela nr. 5 – Analiza financiare për periudhën 1999 – 2016

Viti	Pasuri	Ndryshim likuiditete cash	Ndryshim likuiditete bankë	Të ardhurat	Detyrimet	Shpenzime	Diferenca për shpenzime	Balanca negative në fund të vitit
1999 - 2003	0	0	0	2,060,506	0	992,087	1,068,419	0
2004	0	0	0	540,948	0	207,728	333,220	0
1.1.2005 - 6.1.2009	0	800,000	6,316	2,093,951	0	1,139,612	148,023	0
7.1.2009 - 31.12.2009	0	350,000	681,670	938,182	0	273,240	-366,728	-366,728
2010	0	250,000	-620,890	826,056	0	469,075	727,870	0
2011	0	0	-60,857	816,083	0	458,083	418,857	0
2012	172,448	0	-3,818	876,443	0	636,478	71,336	0
2013	0	0	-684	1,023,987	0	433,315	591,355	0
2014	0	0	-1,649	1,456,371	0	672,221	785,798	0
2015	0	0	10,221	1,565,754	0	943,799	611,734	0
2016	0	133,380	761,553	3,290,245	-286,608	1,613,255	495,449	0
TOTAL	172,448	1,533,380	771,862	15,488,525	- 286,608	7,838,894	4,885,334	-366,728

7.2. Në përfundim, lidhur me likuiditetet e deklaruar në deklaratën *Vetting* 2017, në vlerën totale prej 13.200 euro, duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën 366.728 lekë, si rezultat i mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e kursimeve gjatë vitit 2009, rrethanë e cila është analizuar në paragrafët 1.39 - 1.45 të vendimit.

Përfundimet e Komisionit lidhur me vlerësimin e pasurisë

8. Trupi gjykues në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë arrin në këto përfundime:

*Lidhur me pasurinë, vlerë monetare në shumën 13.200 euro, të deklaruar në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën*

⁹⁶ https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/ILC_LI01_custom_6060101/default/table?lang=en

⁹⁷ Përlogaritë 3.27 muaj *12.765 euro/12 muaj.

⁹⁸ Shpenzime shkollimi në vlerën 329 euro; shpenzime qiraje dhe të tjera në vlerën totale 4.069 euro.

⁹⁹ Për sa i përket periudhës së jetesës me prindërit përpara fillimit të detyrës, për efekt të analizimit të burimeve specifike të kursimeve prej 800.000 lekësh, referojuni tabelës nr. 2. Në analizën financiare të subjektit të paraqitur në tabelën nr. 7 dhe në aneksin nr. 1, për periudhën 1.1.2005 – 6.1.2009 u pasqyruan kursimet *cash* prej 800.000 lekësh, për shkak të analizimit të mëtejshëm të likuiditeteve *cash*.

366.728 lekë, si rezultat i mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e kursimeve gjatë vitit 2009, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

*Lidhur me pasurinë automjet me targë ****, subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme financiare për blerjen e tij në shumën 1.000 euro në vitin 2012.

Lidhur me pasurinë apartament në Shkodër: (i) për sa i përket mënyrës së përfitimit të pjesës takuese nuk konstatohen problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016; (ii) për sa i përket përfitimit të shumës 150.000 lekë nga shitja e apartamentit, deklarimi i subjektit të rivlerësimit është i saktë në përputhje me ligjin, me burime të ligjshme financiare, duke plotësuar kërkesat e shkronjës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me adresat e banimit: (i) deklarimi i subjektit të rivlerësimit është i mbështetur në dokumentacionin justifikues; (ii) nuk konstatohen rrethana apo të dhëna që lidhen me gëzimin e ndonjë të drejte tjetër reale nga ajo e banimit mbi pasuritë e deklaruara si adresa banimi nga subjekti i rivlerësimit.

*Lidhur me gjendjen e llogarisë në *** Bank, Berlin, me vlerë 9.013 euro, në emër të vajzës së subjektit*: (i) deklarimi i subjektit të rivlerësimit përputhet me dokumentacionin e administruar; (ii) personi tjetër i lidhur/nëna e subjektit të rivlerësimit ka pasur burime financiare të ligjshme për dhurimin e shumës 10.000 euro mbesës së saj/vajzës së subjektit, I. Ç., në vitin 2016, duke plotësuar kriteret e parashikuara në shkronjën “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me shpenzimet e shkollimit në Gjermani të vajzës, subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të mjaftueshme të ligjshme financiare për mbulimin e shpenzimeve të shkollimit.

9. Bazuar në sa më sipër, subjekti i rivlerësimit Alma Kodraliu ka arritur nivel të besueshëm për vlerësimin e pasurisë.

B. KONTROLLI I FIGURËS

1. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, AKSIK-ja ka dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 2.6.2023, raportin e deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 2.6.2023, të KDZH-së, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

2. Sipas raportit, subjekti i rivlerësimit Alma Kodraliu: (a) ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar; (b) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga vetë ai në deklaratën për kontrollin e figurës; (c) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

3. Pavarësisht raportit të dërguar nga AKSIK-ja, Komisioni ka kryer hetim administrativ, prej të cilit rezulton se konstatimet e Grupit të Punës për kontrollin e figurës janë të sakta.

4. Bazuar në faktet e sipërpërmendura, Komisioni vlerëson se: (a) subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratën për kontrollin e figurës në kohën e përcaktuar nga ligji nr. 84/2016; (b) nuk ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar; (c) nuk ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kontrollin e figurës, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

1. Sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, relatori përgatit relacionin për vlerësimin e aftësive profesionale, mbështetur në raportin e inspektorëve, informacionin e marrë nga burime të tjera, si dhe në kriteret e vlerësimit, të parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve dhe akteve të tjera ligjore.

2. Këshilli i Lartë Gjyqësor si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka përgatitur raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Alma Kodraliu.

3. Ky raport ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) aftësive profesionale;
- b) aftësive organizative;
- c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale;
- ç) aftësive personale dhe angazhimit profesional.

4. Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit bashkë me 3 dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit; (ii) 5 relacioneve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.

5. Nga shqyrtimi i të dhënave në dosjen personale konstatohet se subjekti i rivlerësimit nga data 25.6.2010 deri në prill 2013 ka ushtruar funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec. Në vijim, në periudhën nga 6.5.2013 – 3.5.2016 ka ushtruar detyrën e ndihmëses ligjore pranë Gjykatës së Lartë. Pas përfundimit të periudhës si ndihmëse ligjore pranë Gjykatës së Lartë, KLD-ja, me vendimin nr. ***, datë 27.5.2016, ka vendosur kthimin e subjektit në vendin e punës si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

6. Aftësitë profesionale

Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit Alma Kodraliu ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 5 nga 8 dokumentet ligjore të vëzhguara është konstatuar se është pasqyruar saktë dhe në mënyrë të detajuar mendimi i ndihmësit ligjor, i argumentuar lidhur me ligjin e zbatueshëm material dhe procedural, si dhe propozimi për zgjidhjen konkrete të çështjes. Në dy prej tyre nuk është pasqyruar mendim konkret, ndërsa një prej dokumenteve të përzgjedhura nga subjekti është vendim gjyqësor civil që ka pranuar padinë.

Arsyetimi ligjor

Dy relacionet nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë relacionet e përzgjedhura me short janë të shkruara qartë, në mënyrë të kuptueshme me strukturë të mirorganizuar, por vetëm në 3 prej tyre rezulton i evidentuar edhe mendimi i subjektit të rivlerësimit për pretendimet e ngritura. Në relacionet e vëzhguara, në 2 dokumentet ligjore, mendimi i ndihmësit ligjor është i paorganizuar. Në 3 raste mendimi i ndihmësit ligjor përputhet me vendimmarrjen e gjykatës, por vetëm në njërin prej tyre paraqitet edhe mendimi konkret për zgjidhjen e çështjes.

Hetimi i Komisionit

7. Pavarësisht raportit të dërguar nga KLGJ-ja, Komisioni kreu një hetim të pavarur në lidhje me tri dokumentet e përzgjedhura nga subjekti dhe me pesë dosjet e shortuara sipas një shorti objektiv. Pas analizimit të tyre u konstatuan problematika dhe u kërkuan shpjegime për dokumentet 1 dhe 3, të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe për 5 relacionet e shortuara, si vijon:

8. Lidhur me dokumentin nr. 1, relacionin për çështjen administrative nr. *** akti që i përket çështjes gjyqësore me palë: paditës/i kundërpaditur H. H.; të paditur/kundërpaditës I. Gj. etj.; i paditur në padi AKKP Vlorë; persona të tretë në kundërpadi S. H. etj., me objekt të padisë “Anulimi pjesërisht i vendimit nr. ***, datë 19.12.2007, i AKKP Vlorë”, me objekt të kundërpadisë “Shpallje absolutisht e pavlefshme e AMTP-së nr. *** regj., datë 16.6.1996”, Komisioni kërkoi shpjegime nga subjekti i rivlerësimit për konstatimin se: *Lidhur me çështjen e tretë të paraqitur për unifikim, subjekti nuk ka analizuar legjislacionin në fuqi për nxjerrjen e akteve të marrjes së tokës në pronësi, si dhe nuk ka sugjeruar zgjidhje apo propozim për unifikim përpara Kolegjeve të Bashkuara, sikurse parashikohet në ligjin nr. 8588/2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.*

9. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁰⁰ subjekti i rivlerësimit shpjegon se veprimtaria e ndihmësit ligjor konsiston në studimin e dosjes dhe përpilimin e relacionit në të cilin sqarohen rrethanat e faktit, qëndrimet dhe shkaqet e vendimmarrjes nga gjykatat më të ulëta, shkaqet e rekursit apo kundërrkursit, ngritja e problematikave që vihen re në interpretimin apo zbatimin e ligjit nga ana e gjykatave, si dhe çështje për diskutim nga ana e trupës gjyqësore. Po kështu, ndihmësi jep edhe sugjerime për zgjidhjen e çështjes, të cilat nuk janë të domosdoshme sa i takon mënyrës se si duhet dhënë vendimi. Për më tepër, shqyrtimi dhe relatimi i dosjes kryhet nën udhëheqjen e gjyqtarit me të cilin ndihmësi punon. Vendimmarrja është atribut i trupës gjyqësore.

10. Lidhur me dokumentin nr. 3, vendimin civil nr. ***, datë 21.11.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me palë: paditës shoqëria “****” sh.p.k.; të paditur shoqëria “****” sh.p.k. dhe Zyra Përmbarrimore “****” sh.p.k.; me objekt “Pezullimi i ekzekutimit të titullit ekzekutiv lidhur me faturat tatimore, si dhe pavlefshmëri e titullit ekzekutiv”, Komisioni kërkoi shpjegime nga subjekti i rivlerësimit për konstatimin se: *Vendimi nr. ***, datë 21.11.2016, lidhur me faturën nr. ***, datë 11.12.2015, është i paqartë, pasi argumentet e pjesës arsyetuese nuk mbështesin pjesën urdhëruese.*

¹⁰⁰ Email datë 12.6.2023.

11. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁰¹ subjekti i rivlerësimit shpjegon se në vlerësimin e saj për këto fatura nuk do të duhej të lëshohej urdhri i ekzekutimit, duke u orientuar palët që të ngrenë padi themeli për të verifikuar marrëdhënien ndërmjet tyre dhe përmbushjen e detyrimeve reciproke. Megjithatë, vijon subjekti, pala debitore nëse nuk është dakord mund të kundërshtojë detyrimin dhe ekzistencën e tij nëpërmjet padisë së pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv. Më pas shpjegon se gjyqtari që shqyrton padinë e pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv ndodhet para faktit që mbi bazën e një vendimi gjyqësor kanë filluar procedurat përmbarimore dhe është i detyruar të shqyrtojë në themel marrëdhënien ndërmjet palëve lidhur me titujt që kundërshtohen si të tillë, duke zgjidhur mosmarrëveshjen ndërmjet palëve. Gjithashtu, subjekti shpjegon se: *“Pak rëndësi ka nëse faturat objekt gjykimi duheshin konsideruar apo jo tituj ekzekutivë, pasi nuk mund të hyja në vlerësimin e tyre dhe as të dilja në një tjetër konkluzion nga ai që kishte dalë gjyqtari që ka shqyrtuar kërkesën për lëshim urdhri ekzekutimi”*.

12. Lidhur me dosjet 1¹⁰², 2¹⁰³ dhe 3¹⁰⁴ Komisioni kërkoi shpjegime nga subjekti i rivlerësimit për konstatimin se: *Subjekti nuk ka dhënë mendim lidhur me themelin e çështjes, për mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit material e procedural nga gjykatat e faktit, sikurse parashikohet në nenin 21 të ligjit nr. 8588/2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.*

13. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁰⁵ subjekti i rivlerësimit shpjegon se ligji nr. 8588/2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”, ka pasur një tjetër organizim dhe varësi pune nga ligji aktual. Ndihmësit ligjorë ishin të atashuar pranë një gjyqtari dhe e kishin punën të lidhur me të. Në këtë drejtim edhe relacionet hartoheshin në lidhje me aq sa ishte e nevojshme të relatohej për trupën gjyqësore. I rëndësishëm ishte identifikimi i saktë i fakteve dhe nxjerrja e çështjeve të diskutueshme ose paqartësive dhe më tej diskutohej nga gjyqtarët.

14. Lidhur me dosjen 4, relacion për çështjen administrative nr. ***, që i përket çështjes administrative me palë: paditës shoqëria “***” sh.p.k.; të paditur Drejtoria e Tatimeve F., Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë, me objekt “Goditja pjesërisht e akteve administrative njoftim vlerësimi tatimor dhe vendimit të Komisionit të Apelimit Tatimor”, Komisioni kërkoi shpjegime nga subjekti i rivlerësimit për konstatimin se: *Subjekti në relacionin e çështjes administrative nr. *** nuk ka verifikuar faktin që pala paditëse nuk e ka parapaguar detyrimin tatimor përpara paraqitjes së ankimit administrativ dhe padisë në gjykatë, sipas parashikimeve të ligjit nr. 8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe orientimit të dhënë nga jurisprudenca e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.*

¹⁰¹ Email datë 12.6.2023.

¹⁰²Relacioni për çështjen administrative nr. ***, që u përket palëve ndërgjyqëse: paditës shoqëria “***” sh.p.k.; i paditur Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve; person i tretë Ministria e Drejtësisë, me objekt “Përmbushje detyrimi kontraktor dhe shpërblimi i dëmit”.

¹⁰³ Relacion për çështjen administrative nr. ***, që i përket paditësit P. P.; i paditur universiteti “***”, Durrës, me objekt “Shfuqizimi tërësisht i urdhrat për shkarkimin nga detyra”.

¹⁰⁴ Relacion për çështjen administrative nr. *** që i përket palëve: paditës Komisioni i Verifikimit të Titujve të Pronësisë-Prefektura e Qarkut Durrës; të paditur Bashkia ***, M. Gj., me objekt pavlefshmëri e aktit administrativ të marrjes së tokës në pronësi.

¹⁰⁵ Email datë 12.6.2023.

15. Lidhur me dosjen 5, relacion për çështjen administrative nr. ***, që i përket çështjes administrative me palë: paditës B. S.; e paditur Bashkia K., me objekt “Kthimi në vendin e punës në pozicionin inxhinier kimiste, detyrimin për pagimin e diferencës së pagës”, Komisioni kërkoi shpjegime nga subjekti i rivlerësimit për konstatimin se: *Mendimi i subjektit në relacion e çështjes administrative nr. *** se “paditësja e ka pranuar pozicionin e ri të punës edhe pas ndryshimit të kushteve të punës” nuk është i mbështetur në rrethanat faktike dhe në nenin 21 të Kodit të Punës.*

16. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁰⁶ subjekti i rivlerësimit shpjegon se relacioni ka sqaruar shkaqet e rekursit dhe nëse ato ngrinin çështje ligjore në drejtim të interpretimit të gabuar të ligjit, duke dhënë edhe mendimin në lidhje me mospranimin e rekursit. Fakti që çështjet e parashtruara nuk kanë gjetur pasqyrim në vendimin e Kolegjit, vijon shpjegimin subjekti i rivlerësimit, nuk përbën asnjë tregues, sa kohë që ishin gjyqtarët ata që identifikonin çështjet e rëndësishme për t’u trajtuar në vendim, pa u lidhur me mendimin e ndihmësit ligjor.

17. Trupi gjykues, në analizë të dy dokumenteve nga publiku dhe shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit në raport me ligjin e zbatueshëm për vlerësimin e aftësive profesionale, arrin në përfundimin se pasaktësitë në drejtim të arsyetimit dhe njohurive ligjore për 5 çështjet e trajtuara më lart qëndrojnë, duke u ndodhur në kushtet e pikave 2 dhe 3 të nenit 72 të ligjit nr. 84/2016, por referuar shpjegimeve të subjektit, si dhe vendimit nr. 2, datë 18.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese, ato nuk mund të përbëjnë shkak për vlerësimin negativ, për aq kohë sa nuk janë gabime thelbësore dhe serioze, të cilat do të ndikonin në vlerësimin e subjektit si të paaftë profesionalisht.

18. Aftësitë organizative

Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit Alma Kodraliu, në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, ka ushtruar detyrën e ndihmëses ligjore në Gjykatën e Lartë deri në datën 3.5.2016, ndërsa pas kësaj date detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Sipas të dhënave statistikore të Gjykatës së Lartë rezulton se ndihmësja ligjore Alma Kodraliu ka hartuar gjithsej në Gjykatën e Lartë 377 akte të relatimit të çështjeve (375 me natyrë administrative dhe 2 me natyrë civile).

Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Në të gjitha praktikat e administruara nuk ka dokumentim të veprimeve të kryera nga ndihmësi ligjor me qëllim matjen saktësisht të kësaj aftësie.

Aftësia për të administruar dosjet

Në 3 nga 5 relacionet e përzgjedhura me short rezulton se mendimi i ndihmësit ligjor është përfshirë në dosjet fizike përkatëse. Në dokumentet e paraqitura dhe në relacionet e shortuara nuk identifikohet koha e përpilimit të tyre, pasi aktet nuk kanë datë dhe as nënshkrim të subjektit të rivlerësimit.

19. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

Etika në punë

¹⁰⁶ Email datë 12.6.2023.

Nga informacioni i administruar nga KLGJ-ja nuk konstatohen të dhëna nga burimet arkivore për etikën e ndihmësës ligjore Alma Kodraliu.

Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Alma Kodraliu dhe nga 5 dokumentet e vëzhguara nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

Paanësia

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 relacionet e vëzhguara nuk lidhen me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 relacionet e vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

20. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

Aftësitë e komunikimit

Në 7 nga 8 dokumentet ligjore të vëzhguara nuk ka të dhëna për mënyrën e komunikimit të subjektit të rivlerësimit me palët ndërgjyqëse për shkak të natyrës së punës, ndërsa gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

Aftësia për të bashkëpunuar

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 relacionet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit Alma Kodraliu për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti i rivlerësimit ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit Alma Kodraliu, megjithëse nuk ishte subjekt që trajnohej nga Shkolla e Magjistraturës, ka deklaruar se ka qenë pjesëmarrëse e 10 seminareve që i përkasin periudhës së rivlerësimit në 3 vitet e fundit. Lidhur me trajnimet e tjera jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se gjatë ushtrimit të detyrës së ndihmësimit ligjor pranë Gjykatës së Lartë ka marrë pjesë në 5 aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat vërtetohen nga Gjykata e Lartë. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur edhe 5 shkrime të botuara.

Të dhëna nga burimet arkivore të KLGJ-së

21. Rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, subjekti Alma Kodraliu ka ushtruar detyrën e ndihmësës ligjore pranë Gjykatës së Lartë dhe nga data 27.5.2016 deri në datën 8.10.2016 ka ushtruar detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave nuk është paraqitur asnjë ankesë në Inspektoratin e KLD-së.

22. Referuar regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Alma Kodraliu, përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk është paraqitur asnjë kërkesë për procedim disiplinor nga

Ministria e Drejtësisë apo të jetë marrë ndonjë masë disiplinore nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Hetimi i Komisionit në raport me ankesat e paraqitura në KLD dhe në Ministrinë e Drejtësisë

23. Referuar nenit 77 të ligjit nr. 96/2016, një nga burimet e vlerësimit të magjistratit janë të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj magjistratit gjatë periudhës së vlerësimit. Për rrjedhojë, Komisioni administroi nga KLGJ-ja¹⁰⁷ korrespondencën dhe dokumentacionin e administruar nga ish-KLD-ja, ankesat e paraqitura në Ministrinë e Drejtësisë¹⁰⁸, ku rezultoi se në këtë institucion janë paraqitur 2 ankesa.

24. Pas analizimit të tyre u konstatuan problematika dhe u kërkuan shpjegime për ankesën si vijon:

25. Lidhur me ankesën e shtetasit F. D., i cili është ankuar për vendimin për kthimin e padisë, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit për konstatimin: *Subjekti ka marrë vendimin nr. ***, datë 6.6.2018, për kthimin e padisë duke mos zbatuar parashikimet e nenit 154/a të Kodit të Procedurës Civile, e cila ka sjellë si pasojë cenimin e të drejtës së aksesit në gjykatë të paditësve.*

26. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁰⁹ subjekti i rivlerësimit shpjegon se në rastin konkret padia është kthyer menjëherë pa i lënë kohë për plotësim të metash, në kushtet kur nuk mund të konsiderohej padi pasi, duke pasur parasysh dispozitat ligjore, padia si akt procedural duhet të përmbajë tregimin fakteve, rrethanave, që e kanë detyruar paditësin të ngrejë padi, i cili është personi që ka shkelur të drejtat e paditësit dhe çfarë kërkohet të vendoset përmes forcës shtrënguese të gjykatës. Në rastin konkret, vijon subjekti i rivlerësimit, objekti i padisë dhe pjesa arsyetuese e saj nuk shpjegojnë se çfarë kërkojnë të arrijnë përmes gjykatës paditësit, ndaj kujt drejtohen kërkimet e tyre dhe identifikimi i provave që vërteton këto pretendime. Gjithashtu, shpjegon se duke supozuar që gjykata do të linte kohë për plotësimin e të metave të padisë, ky rregullim do të konsistonte në një padi të re, pasi qartazi kërkimet në objektin e padisë nuk kanë kuptim.

27. Më pas, sqaron se pas kthimit për rigjykim paditësit nuk janë paraqitur pa ndonjë shkak të arsyeshëm në seancë dhe gjykata, me vendimin nr. ***, datë 18.11.2019, ka vendosur pushimin e gjykimit. Ky vendim ka marrë formë të prerë pasi nuk është ankimuar nga paditësit. Bashkë me shpjegimet subjekti i rivlerësimit ka paraqitur vendimin e mësipërm të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku pasqyrohet shënimi i marrjes së formës së prerë në datën 17.12.2019.

DENONCIME

28. Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit Alma Kodraliu janë administruar 12 denoncime nga publiku. Referuar nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kërkoi shpjegime për denoncimet, si vijon:

¹⁰⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 12.2.2021.

¹⁰⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 1.2.2021.

¹⁰⁹ Email datë 12.6.2023.

28.1 Në lidhje me denoncimin nr. * prot., datë 21.5.2019**, të shtetasit S. J., i cili akuzon subjektin e rivlerësimit për marrjen e një vendimi të padrejtë dhe të pambështetur në ligj, Komisioni kërkoi shpjegime nga subjekti i rivlerësimit për konstatimin se: *Arsyetimi i subjektit në vendimin nr. ***, datë 10.5.2019, se padia e paditësit është parashkruar për shkak të plotësimit të afatit të parashkrimit për të kërkuar dëmin jashtëkontraktor është i paqartë, pasi nuk mbështetet në rrethanat faktike të mosmarrëveshjes.*

Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹¹⁰ subjekti i rivlerësimit shpjegon se nuk është në juridiksionin kushtetues të Komisionit të marrë në shqyrtim elemente që përcaktojnë zgjidhjen në themel të një mosmarrëveshjeje, si p.sh. cilësimi i marrëdhënies juridike, vlerësimi i provave, etj. Po kështu, thekson se çështja ndodhet në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, e ankimuar nga paditësi dhe nuk është shqyrtuar ende. Për këtë paraqet si provë vërtetimin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm. Megjithatë, vijon subjekti i rivlerësimit, në kuadër të përmbushjes së detyrimit për të qenë bashkëpunues me Komisionin shpjegon se kërkimi i paditësit nuk është i natyrës kontraktore, për shkak se konflikti nuk ka ardhur nga ekzekutimi i kontratës për shitjen prej tij të banesës 2+1. Shkaku i kërkimit ka të bëjë me vendimmarrjen e Ministrisë së Financave, e cila i ka zbritur paditësit një vlerë monetare nga kompensimi që i takonte. Kësisoj, shkaku real i kërkimit dhe ajo çfarë paditësi kërkon në padi nuk kanë lidhje me njëra-tjetrën, ndërkohë që, paditësi do të duhej të kundërshtonte vendimmarrjen e Ministrisë e, po kështu, kësaj të fundit t'i kërkonte edhe kthimin e shumave të ndalura në mënyrë të padrejtë, përfshirë fitimin e munguar.

28.2 Në lidhje me denoncimin nr. * prot., datë 15.6.2022**, të shtetasës V. S., e cila akuzon subjektin për zvarritjen e gjykimit, Komisioni kërkoi shpjegime nga subjekti i rivlerësimit për konstatimin se: *Gjykimi në shkallë të parë e ka tejkaluar afatin e arsyeshem të përfundimit të gjykimit të parashikuar në nenin 399/2 të Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon se afati i arsyeshem i përfundimit të gjykimit civil në shkallë të parë është brenda dy viteve.*

Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹¹¹ subjekti i rivlerësimit, pasi sqaron në mënyrë kronologjike seancat gjyqësore, shpjegon se Komisioni duhet të mbajë parasysh: *së pari*, çështja ka qenë pranë një tjetër gjyqtari dhe kur është marrë është vënë në lëvizje, nga ana e saj kalendari i gjykimit ka qenë shumë i ngarkuar, pasi ngarkesa e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është jashtë çdo standardi, ku përveç çështjeve të reja që shortohen, kohë pas kohe janë shortuar edhe çështjet e gjyqtarëve të shkarkuar; *së dyti*, duke pasur parasysh praktikën e konsoliduar¹¹² duhet pasur parasysh sjellja e palëve, kompleksiteti i çështjes, etj. *Së fundi*, kërkon të mbahet parasysh se ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të zhvilluar gjykimin brenda afateve ligjore dhe nuk kanë qenë veprimet e saj që kanë sjellë vonesën në përfundimin e gjykimit të çështjes, por rrethana të tjera, si mbingarkesa, fakti që ka qenë pranë një tjetër trupe gjyqësore, sjellja e palëve në gjykim dhe fakti që përfaqësuesi i palës paditëse ka mbajtur në gjykim qëndrime të ndryshme nga ato të pretenduara nga paditësja. Bashkëlidhur shpjegimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kopje të procesverbaleve të seancave gjyqësore.

¹¹⁰ Email datë 12.6.2023.

¹¹¹ Email datë 12.6.2023.

¹¹² Të GJEDNJ-së, Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë.

Përfundimet e Komisionit në lidhje me rivlerësimin e aftësive profesionale

29. Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj ka çmuar se vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale¹¹³.

29.1 Trupi gjykues, në analizë të dy dokumenteve të paraqitura nga subjekti, dosjeve të shortuara, denoncimeve nga publiku, shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit në raport me ligjin e zbatueshëm për vlerësimin e aftësive profesionale, arrin në përfundimin se pasaktësitë e konstatuara në drejtim të arsytimit dhe njohurive ligjore për çështjet e trajtuara më lart qëndrojnë, duke u ndodhur në kushtet e pikave 2 dhe 3 të nenit 72 të ligjit nr. 84/2016, por referuar shpjegimeve të subjektit, si dhe vendimit nr. 2, datë 18.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese, ato nuk mund të përbëjnë shkak për vlerësimin negativ, për aq kohë sa nuk janë gabime thelbësore dhe serioze, të cilat do të ndikonin në vlerësimin e subjektit si të paaftë profesionalisht.

30. Në vijim, trupi gjykues, bazuar në jurisprudencën e Gjykatës së Kushtetuese, si dhe duke marrë në konsideratë: (i) numrin e çështjeve të analizuara ku janë konstatuar mangësi në aspektin e aftësive profesionale në raport me çështjet e ndjekura nga subjekti i rivlerësimit për periudhën e rivlerësimi 8.10.2013 – 8.10.2016 dhe me faktin që ka ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Lartë dhe nën drejtimin dhe kontrollin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë; (ii) mangësitë e konstatuara si më lart nuk janë të një niveli të tillë që të konsiderohen serioze dhe as të përsëritura në mënyrë të vazhdueshme, që të përfaqësojnë defekte të rëndësishme për njohuritë profesionale; (iii) nuk rezulton që veprimet e subjektit të rivlerësimit mund të kenë qenë të qëllimshme dhe në kundërshtim të hapët dhe flagrant me ligjin apo me praktikat unifikuese të gjykatave më të larta, bazuar edhe në parimin e proporcionalitetit – vlerëson se konstatimet e pasqyruara në kriterin e rivlerësimit të aftësive profesionale nuk plotësojnë kushtin e parashikuar nga pika 4 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, që subjekti i rivlerësimit të konsiderohet “i papërshtatshëm”.

31. Në përfundim, trupi gjykues i Komisionit, në vlerësimin tërësor të kriterit të rivlerësimit të aftësive profesionale, vlerëson se subjekti i rivlerësimit Alma Kodraliu është “e aftë”, pasi ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve dhe është eficient në masë të pranueshme.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në provat që disponon për vlerësimin e pasurisë, vlerësimin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, vendosi që subjekti i rivlerësimit Alma Kodraliu, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të konfirmohet në detyrë.

¹¹³ Vendim nr. 2, datë 18.1.2017.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe pikën 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Kodraliu, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 19.6.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Brunilda BEKTESHI
Kryesuese

Etleda ÇIFTJA
Relatore

Lulzim HAMITAJ
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Resilda Bilaj